



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2025 – Numri: 213

Tiranë – E hënë, 17 nëntor 2025

PËRMBAJTJA

	Faqe
Dekret i Presidentit nr. 391, datë 12.11.2025	Për lejimin e lënies të shtetësisë shqiptare..... 25447
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 682, datë 12.11.2025	Për një ndryshim në vendimin nr. 15, datë 9.1.2025, të Këshillit të Ministrave, “Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor për vitin 2025”, të ndryshuar..... 25447
Udhëzim i ministrit të Financave nr. 24, datë 6.11.2025	Për disa shtesa dhe një ndryshim në udhëzimin e përgjithshëm nr. 26, datë 8.9.2023, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar..... 25449
Udhëzim i ministrit të Financave nr. 25, datë 11.11.2025	Për mënyrat dhe procedurat për raportim nga organet doganore..... 25458
Udhëzim i ministrit të Arsimit nr. 25, datë 10.11.2025	Për një shtesë në udhëzimin nr. 6, datë 4.3.2020, të ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, “Për përcaktimin e rregullave për afatet e aplikimit, të zbatimit të kriterëve dhe procedurave, për përcaktimin e masës dhe mënyrës së financimit, si dhe numrin e anëtarëve dhe kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve për anëtarë komisioni për dhënien e bursave të parashikuara nga Fondi i Ekselencës për studentët e shkëlqyer dhe nëpunësit civilë”..... 25467
Udhëzim i ministrit të Financave nr. 140, datë 7.11.2025	Për shtyrjen e afatit të aplikimit të Standardit Ndërkombëtar të Raportimit Financiar 17 (SNRF 17) “Kontratat e Sigurimit”..... 25467
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 1161, datë 7.11.2025	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Suedisë..... 25468

Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 1162, datë 7.11.2025	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Gjermanisë	25468
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 51, datë 25.9.2025	Me objekt shfuqizimin e vendimit nr. 00-2024-3271, datë 23.7.2024, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Zhvillimin e gjykimit nga një gjykatë jokompetente, për shkak të konflikteve të herëpashershme me gjyqtaren A.A. të Gjykatës së Lartë, duke qenë relatore e çështjes. Konstatimin e cenimit të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, si rezultat i mosgjykimit të çështjes brenda një afati të arsyeshëm, të parashikuar në pikën 2 të nenit 399/7 të Kodit të Procedurës Civile, të kërkesës nr. regjistrimi 31138-04501-86-2017, datë 11.9.2017, pranë sekretarisë së Gjykatës Administrative të Apelit dhe përsheptimitin e shqyrtimit të çështjes, pasi ende nuk është gjykuar.....	25470
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 56, datë 10.10.2025	Me objekt shfuqizimin e vendimeve nr. 24 (86-2017-1981), datë 9.5.2017, të Gjykatës Administrative të Apelit; nr. 00-2024-2777, datë 27.6.2024, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën Administrative të Apelit.....	25474
Vendim i Këshillit të Lartë të Prokurorisë nr. 339, datë 3.11.2025	Për miratimin e rregullores “Për Kodin e Etikës dhe parandalimin e konfliktit të interesit për anëtarët e Këshillit të Lartë të Prokurorisë”	25483
Kërkesë e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin nr. 880/10, datë 11.11.2025	Për shpronësim, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rikonstruksion i rrugës ekzistuese ‘Xhaferr Belegu’, ndodhur në ZK 8527, Bashkia Elbasan”	25486
Kërkesë e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin nr. 942/8, datë 11.11.2025	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Baza Ajrore Farkë”, me vendndodhje në Bashkinë Tiranë, me subjekt zhvillues Ministrinë e Mbrojtjes.....	25488
Kërkesë e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin nr. 980/7, datë 11.11.2025	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rikonstruksion rruga ‘Marin Biçikemi’”	25491
Kërkesë e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin nr. 1073/6, datë 11.11.2025	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rikonstruksion trotuari perimetral shkollë 9-vjeçare ‘Ndre Mjeda’”	25493
	Kërkese për shpalljen të zhdukur të shtetasit Saimir Gjergji.....	25495
	Korrigjim gabimi material në urdhrin nr. 1120, datë 3.11.2025, të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, “Për miratimin e rregullores ‘Për menaxhimin e peshkimit në Zonën e Kufizuar të Peshkimit në Kanalin e Otrantos (GSA 18)’”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 209, datë 12.11.2025.....	25495



DEKRET
Nr. 391, datë 12.11.2025

PËR LEJIMIN E LËNIES TË
SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronja “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 13, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme

DEKRETOJ:

Neni 1

I lejohe lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tij, shtetasit:

1. Kastriot Enver Harizi

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

VENDIM
Nr. 682, datë 12.11.2025

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN
NR. 15, DATË 9.1.2025, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR FINANCIMIN E
SHËRBIMEVE SHËNDETËSORE
SPITALORE NGA SKEMA E
DETYRUESHME E SIGURIMEVE TË
KUJDESIT SHËNDETËSOR PËR VITIN
2025”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5, të ligjit nr. 115/2024, “Për buxhetin e vitit 2025”, të ndryshuar, të nenit 10, të ligjit nr. 10383, datë 24.2.2011, “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të

ndryshuar, dhe të nenit 53, të ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 15, datë 9.1.2025, të Këshillit të Ministrave, “Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor për vitin 2025”, të ndryshuar, shtojca nr. 2 ndryshohet me shtojcën me të njëjtin numër, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Ministria e Financave dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku



SHTOJCA NR. 2
BUXHETI PËR SHËRBIMIN SPITALOR

000 lekë

EMERTIMI	ARTIKUJT						
	art.600	art.601	art.602	art.602 PPP laboratorë	604	rezerve	total
QSR BERAT	535,100	87,900	200,000	64,000	0	0	887,000
BULQIZE	114,300	18,850	30,000	0	0	0	163,150
DELVINE	54,360	9,020	7,000	0	0	0	70,380
DEVOLL	69,920	11,500	12,000	0	0	0	93,420
DIBER	392,080	63,900	135,000	33,000	0	0	623,980
ELBASAN	694,600	113,550	250,000	110,000	0	0	1,168,150
FIER	560,500	91,950	238,000	115,000	0	0	1,005,450
GRAMSH	174,270	28,650	35,000	0	0	0	237,920
GJIROKASTER	328,100	52,950	120,000	36,000	0	0	537,050
HAS	65,510	10,870	16,000	0	0	0	92,380
KOLONJE	114,460	18,520	20,000	0	0	0	152,980
KORCE	642,000	105,700	295,000	85,000	0	0	1,127,700
KRUJE	178,420	29,420	32,000	0	0	0	239,840
KUKES	374,600	61,900	136,000	37,000	0	0	609,500
KURBIN	132,250	21,980	37,000	0	0	0	191,230
LEZHE	402,900	65,140	190,000	65,000	0	0	723,040
LIBRAZHD	214,900	35,010	54,000	0	0	0	303,910
LUSHNJE	328,150	53,830	107,000	48,000	0	0	536,980
MALESI E MADHE	37,300	6,120	6,600	0	0	0	50,020
MALLAKASTER	60,800	10,050	13,000	0	0	0	83,850
MAT	190,100	31,020	40,000	0	0	0	261,120
MIRDITE	144,450	23,780	30,000	0	0	0	198,230
PEQIN	52,100	8,640	7,500	0	0	0	68,240
PERMET	112,750	18,350	35,000	0	0	0	166,100
POGRADEC	250,450	41,000	84,000	0	0	0	375,450
PUKE	141,650	22,900	40,000	0	0	0	204,550
SARANDE	236,650	38,700	120,000	35,000	0	0	430,350
SKRAPAR	111,500	18,410	18,000	0	0	0	147,910
SHKODER	829,300	136,280	396,650	70,000	0	0	1,432,230
TEPELENE	114,100	18,110	16,000	0	0	0	148,210
QSU "NENE TEREZA"	3,771,200	611,190	5,196,845	850,000	0	0	10,429,235
SUOGJ "MBRETERESHA GERALDINE"	441,700	71,600	300,000	33,000	0	0	846,300
SUOGJ "KOCO GLIOZHENI"	350,000	56,290	300,000	34,000	0	0	740,290
QSR "SHEFQET NDROQI"	756,200	122,700	918,700	63,000	0	0	1,860,600
TRAUMA	190,300	30,300	350,000	60,000	0	0	630,600
TROPOJE	146,760	24,270	40,000	0	0	0	211,030
VLORE	594,450	96,780	376,750	78,500	0	0	1,146,480
"MEMORIAL" FIER	0	0	0	0	780,000	0	780,000
DURRËS	0	0	0	83,500	1,480,000	0	1,563,500
Paketat e shërbimeve jopublik	0	0	0	0	1,641,765	0	1,641,765
Transferta për individët (mjekë specialistë)	0	0	0	0	15,000	0	15,000
Trajtime me VKM	0	0	0	0	20,000	0	20,000
Pagesat e shërbimeve PPP	0	0	0	0	2,860,000	0	2,860,000
rezerve	0	0	0	0	0	21,870	21,870
	13,908,180	2,267,130	10,203,045	1,900,000	6,796,765	21,870	35,096,990



UDHËZIM
Nr. 24, datë 6.11.2025

**PËR DISA SHTESA DHE NJË NDRYSHIM
NË UDHËZIMIN E PËRGJITHSHËM NR.
26, DATË 8.9.2023, “PËR TATIMIN MBI TË
ARDHURAT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në zbatim të pikës 2, të nenit 70, të ligjit nr. 29, datë 30.3.2023, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, ministri i Financave

UDHËZON:

Në udhëzimin e përgjithshëm të ministrit të Financave, nr. 26, datë 8.9.2023, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimi, si më poshtë vijon:

1. Në pikën 24.6, bëhen shtesat me përmbajtje si vijon:

Në krye të paragrafit të parë, shtohet togfjalëshi “Shembulli 1.”;

Në fund të shembullit 1, shtohen shembujt me përmbajtje si vijon:

“Shembull 2. Individit “C” gjatë vitit 2025 rezultojnë i punësuar vetëm në muajin maj dhe paga bruto që ka marrë në këtë muaj është 500,000 lekë. I punësuar ka një fëmijë në ngarkim të tij në moshën 10 vjeç dhe ka të ardhurat më të larta në familje, nuk ka aplikuar për zbritje si kontribut në ndonjë fond pensioni privat, por ndërkohë ka nënshkruar Deklaratën e Statusit Personal.

a) Tatimi mbi të ardhurat personale nga punësimi i llogaritur dhe paguar në listëpagesën mujore

Të ardhurat e tatueshme – zbritjet e parashikuara në nenin 22, të ligjit = Bazë e tatueshme e të ardhurës nga punësimi të individit në muajin maj:

$$500,000 \text{ lekë} - 30,000 \text{ lekë} = 470,000 \text{ lekë}$$

$$\text{Tatimi mbi të ardhurat personale nga punësimi} = (170,000 \text{ lekë} * 13\%) + [(470,000 \text{ lekë} - 170,000 \text{ lekë}) * 23\%] = 22,100 \text{ lekë} + 69,000 \text{ lekë} = 91,100 \text{ lekë}$$

b) Tatimi mbi të ardhurat nga punësimi i llogaritur mbi të ardhurat vjetore

Në kushtet që individit nuk ka të ardhura të tjera përveçse të ardhurës nga punësimi, ky individ nuk ka detyrim ligjor për të deklaruar Deklaratën Vjetore të të Ardhurave Personale (DVAP), sipas përcaktimeve ligjore në fuqi. Megjithatë, nëse ky individ zgjedh dhe deklaron DVAP, ku të ardhurat vjetore nga punësimi janë 500,000 lekë, atëherë

zbritja nga baza e tatueshme do të jetë e gjithë shumë prej 500,000 lekësh.

Sipas nenit 22, të ligjit nr. 29/2023 për pagat vjetore deri në 600,000 lekë, lejohet një zbritje deri në 600,000 lekë nga baza vjetore, si dhe një kompensim prej 48,000 lekësh për fëmijën në ngarkim të tij, por në çdo rast baza tatimore nuk mund të jetë më e vogël se zero lekë. Në rastet kur diferenca midis të ardhurave vjetore të tatueshme dhe shumës totale të kompensimeve dhe zbritjeve është negative, baza tatimore vjetore konsiderohet të jetë zero. Në rastin konkret diferenca ndërmjet të ardhurës vjetore të tatueshme nga punësimi me shumën totale të zbritjeve rezultojnë negative prej -148,000 lekësh $[500,000 \text{ lekë} - (600,000 \text{ lekë} + 48,000 \text{ lekë})]$, prandaj në këtë rast baza e tatueshme do të konsiderohet 0 lekë dhe detyrimi tatimor rrjedhimisht është 0 lekë.

c) Deklarata vjetore DVAP rezultojnë me tatim të mbipaguar:

Nëse individit zgjedh të deklarojë DVAP atëherë tatimi i paguar në listëpagesën e muajit Maj, do t'i rimbursohet. Konkretisht administrata tatimore duhet të rimbursojë individin me diferencën ndërmjet tatimit të paguar me tatimin e llogaritur në DVAP = 91,100 lekë – 0 lekë = 91,100 lekë rimbursim për vlerën e mbipaguar nga tatimi mbi të ardhurat personale nga punësimi.

Shembull 3. Individit “D” i dypunësuar në kompaninë “X” dhe kompaninë “Z” gjatë secilit muaj të vitit 2025 ka përfutur të ardhura nga punësimi në nivelin e pagës minimale nga të dy punëdhënësit. Individit i punësuar nuk ka fëmijë në ngarkim të tij, ka dorëzuar Deklaratën e Statusit Personal pranë kompanisë “X” dhe, gjithashtu, nuk ka zbritje të përfutur nga zbritjet për kontribut në ndonjë fond pensioni privat.

a) Tatimi mbi të ardhurat personale nga punësimi i llogaritur dhe paguar në listëpagesën mujore

Të dyja kompanitë do të deklarojnë në listëpagesat mujore përkatëse të ardhurat nga punësimi të individit, konkretisht:

- Kompania “X”, e cila ka të shënuar dhe plotësuar deklaratën e statusit personal, në listëpagesë do të deklarojë të ardhurën nga punësimi prej 40,000 lekësh që individit përfuton, ndërkohë zbritet nga baza e tatueshme e gjithë paga prej 40,000 lekë sipas nenit 22, të ligjit nr. 29/2023, për pagat mujore deri në 50,000 lekë. Tatimi mujor i llogaritur për të ardhurën nga punësimi në kompaninë “X” është 0 lekë pasi baza e tatueshme rezultojnë 0 lekë $[(40,000 \text{ lekë} - 50,000 \text{ lekë}) < 0]$, prandaj llogaritet 0 lekë;

- Kompania “Z”, deklaron të ardhurën e tatueshme prej 40,000 lekë, dhe individit nuk përfuton sipas zbritjeve mujore të nenit 22, të ligjit nr. 29/2023, pasi deklarata e statusit personal është dorëzuar te kompania “X”. Tatimi mujor i llogaritur për të ardhurën nga punësimi në kompaninë “Z”



është 5,200 lekë ($40,000 \text{ lekë} * 13\%$) dhe shuma vjetore e tatimeve mujore të paguara është 62,400 lekë ($5,200 \text{ lekë} * 12 \text{ muaj}$).

b) Tatimi mbi të ardhurat nga punësimi i llogaritur mbi të ardhurat vjetore

Individi ka detyrimin ligjor të deklarojë DVAP, sepse ka qenë i dypunësuar. Të ardhurat bruto vjetore nga punësimi janë 960,000 lekë [$(40,000 \text{ lekë nga kompania "X"} + 40,000 \text{ lekë nga kompania "Z"}) * 12 \text{ muaj}$], ndërsa zbritja nga baza e tatueshme është 360,000 lekë sipas nenit 22 të ligjit 29/2023, për pagat vjetore mbi 720,000 lekë. Tatimi i llogaritur në deklaratën DVAP është 78,000 lekë [$(960,000 \text{ lekë} - 360,000 \text{ lekë}) * 13\%$].

c) Deklarata vjetore DVAP rezulton me tatim për t'u paguar

Duke qenë se tatimi i paguar gjatë vitit është më i vogël se detyrimi tatimor i llogaritur në DVAP, me supozimin që individi nuk ka të ardhura të tjera personale nga punësimi ose investimi, individi duhet të paguajë pranë administratës tatimore diferencën ndërmjet tatimit të llogaritur në DVAP me tatimin e paguar gjatë vitit, pra $78,000 \text{ lekë} - 62,400 \text{ lekë} = 15,600 \text{ lekë}$.

Shembull 4. Individi "E" gjatë vitit 2025 ka pasur të ardhura mujore nga punësimi në shumën 100,000 lekë për 11 muaj nga janari deri në nëntor, ndërsa në muajin dhjetor ky individ ka marrë një shpërblim për performancë të mirë dhe e ardhura nga punësimi në muajin dhjetor është 250,000 lekë. Ndërkohë, individi ka dhe të ardhura nga qiraja prej 240,000 lekë në vit, nga një apartament në pronësi të tij. Kontratën e qirasë e ka lidhur me individin "F". Gjatë këtij viti i punësuar nuk ka zbritje të përfutur nga zbritjet për kontribut në ndonjë fond pensioni privat, nuk ka fëmijë në ngarkim të tij dhe ka nënshkruar Deklaratën e Statusit Personal në listëpagesën mujore.

a) Tatimi mbi të ardhurat personale nga punësimi i llogaritur dhe paguar në listëpagesën mujore

Në këtë rast, tatimi mbi të ardhurat personale nga punësimi do të përlllogaritet në listëpagesë e secilit muaj si në vijim:

- Tatimi mbi të ardhurat personale i llogaritur për muajin janar do të llogaritet mbi bazën e tatueshme pasi zbatohen zbritjet mujore të parashikuara në nenin 22, të ligjit nr. 29/2023. Konkretisht baza e tatueshme është 70,000 lekë ($100,000 \text{ lekë} - 30,000 \text{ lekë}$) dhe tatimi i llogaritur është 9,100 lekë ($70,000 \text{ lekë} * 13\%$).

Duke qenë se kemi po të njëjten nivel të ardhurave nga punësimi për secilin muaj janar-nëntor, tatimi i llogaritur për çdo muaj deri në nëntor është 9,100 lekë/muaj.

- Tatimi për të ardhurat personale nga punësimi për muajin dhjetor do të llogaritet mbi bazën e tatueshme, pasi

zbatohen zbritjet mujore të parashikuara në nenin 22, të ligjit nr. 29/2023. Konkretisht baza e tatueshme mujore është 220,000 lekë ($250,000 \text{ lekë} - 30,000 \text{ lekë}$) dhe tatimi i llogaritur është 33,600 lekë ($170,000 \text{ lekë} * 13\% + 50,000 \text{ lekë} * 23\%$).

- Detyrimet totale tatimore që individi ka paguar për gjithë vitin 2025 në listëpagesa është 133,700 lekë ($9,100 \text{ lekë} * 11 \text{ muaj} + 33,600 \text{ lekë}$).

b) Tatimi mbi të ardhurat nga punësimi i llogaritur mbi të ardhurat vjetore

Individi ka detyrimin ligjor të deklarojë DVAP, pasi të ardhurat vjetore personale janë mbi 1.2 milionë lekë [$(100,000 \text{ lekë} * 11 \text{ muaj} + 250,000 \text{ lekë} + 240,000 \text{ lekë}) = 1,590,000 \text{ lekë}$], si dhe për më tepër ka të ardhura mbi 50,000 lekë (240,000 lekë), të cilat nuk i nënshtrohen tatimit përfundimtar në burim sipas krent V të ligjit.

Tatimi mbi të ardhurat personale nga punësimi sipas DVAP do të llogaritet si më poshtë:

Të ardhurat vjetore për vitin 2025 janë 1,350,000 lekë – Zbritja që përfiton sipas nenit 22 është 360,000 lekë (për të ardhurat vjetore mbi 720,000 lekë) = Baza e tatueshme 990,000 lekë ($1,350,000 \text{ lekë} - 360,000 \text{ lekë}$).

Tatimi sipas DVAP llogaritet 128,700 lekë ($990,000 * 13\%$).

c) Tatimi mbi të ardhurat nga qiraja

Tatimi mbi të ardhurat personale nga qiraja është 36,000 lekë ($240,000 \text{ lekë} * 15\%$).

Duke qenë se kontrata është e lidhur me një individ, për të ardhurën e përfutur nga qiraja individi "E" nuk ka paguar tatim gjatë vitit, prandaj tatimi prej 36,000 lekë rezulton tatim për t'u paguar në DVAP.

ç) Deklarata vjetore DVAP rezulton me tatim për t'u paguar

Tatimi i paguar gjatë vitit nga individi për të ardhurën nga punësimi rezulton më i lartë se tatimi i llogaritur në DVAP, prandaj deklarata rezulton me mbipagim detyrimesh për tatimin për të ardhurat e tij nga punësimi, ndaj administrata tatimore duhet të rimbursojë individin me 5,000 lekë ($133,700 \text{ lekë} - 128,700 \text{ lekë}$) nga të ardhurat nga punësimi. Megjithatë individi ka tatim për të paguar për të ardhurat nga qiraja në vlerën 36,000 lekë. Në këtë rast rimbursimi i tatimit për të ardhurat nga punësimi, do të ulë detyrimin tatimor nga qiraja, dhe deklarata do të rezultojë me një pagesë prej 31,000 lekë (tatimet e llogaritura në DVAP – tatimet e paguara gjatë vitit = $36,000 \text{ lekë} + 128,700 \text{ lekë} - 133,700 \text{ lekë}$).

2. Aneksi nr. 6 bashkëlidhur udhëzimit të përgjithshëm nr. 26, datë 8.9.2023, "Për tatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar, zëvendësohet me aneksin



nr. 6 bashkëlidhur këtij udhëzimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCËVE
Petrit Malaj

Aneksi nr. 6

DEKLARATA VJETORE E TË
ARDHURAVE PERSONALE

(1) Numri Serial:		(2) Periudha tatimore (viti):	
-------------------	--	-------------------------------	--

Vendos X në kutinë e duhur nëse nuk po dorëzon për herë të parë për këtë periudhë të dorëzimit ☐ KORRIGJUESE

SEKSIONI A : TË DHËNA IDENTIFIKUESE

- [3] REZIDENT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË ☐
[4] JOREZIDENT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË ☐

TË DHËNA IDENTIFIKUESE PËR INDIVIDIN

- [5] Emri _____ Seksi: M ☐ F ☐
Atësia _____
Mbiemri _____
[6] Numri i identifikimit personal sipas letërnjoftimit të deklaruesit _____
[7] Adresa kryesore: _____
[8] Qyteti/Komuna/Rrethi: _____
[9] Statusi i Deklaruesit i/e martuar ☐ i/e martuar me fëmijë ☐ beqar/e ☐ i/e ve ☐ i/e divorcuar ☐ kryefamiljar/e ☐

TË DHËNA PLOTËSUESE PËR INDIVIDIN

- [10] Telefoni _____ Cel. _____ Email _____
[11] Të dhëna mbi pronësinë e banesës kryesore: a) në pronësi ☐ b) me qira ☐ c) falas nga pronari ☐ d) të tjerë ☐
[12] Emër/Mbiemër i pronarit, Adresa _____

ADRESA E BANIMIT NËSE ËSHTË E NDRYSHME NGA ADRESA E TË DHËNAVE IDENTIFIKUESE

- [13] Adresa _____
[14] Nr. Tel _____ Cel. _____ E-mail _____
[15] Të dhëna mbi pronësinë e banesës ku jeton: a) në pronësi ☐ b) me qira ☐ c) falas nga pronari ☐ d) të tjerë ☐
[16] Emri/Mbiemri i pronarit _____ Adresa _____

PERSONA NË KUJDESTARINË E DEKLARUESIT

- [17] Persona nën kujdestarinë e deklaruesit gjithsej Numri i personave brenda familjes në kujdestari Të tjerë persona në kujdestari

FËMIJË NËN MOSHËN 18 VJEÇ

- [18] Numri i fëmijëve në ngarkim të deklaruesit nën moshën 18 vjeç
(Plotësohet nga prindi që ka të ardhurat vjetore më të larta në familje)

Personi Deklarues

(Emri/Mbiemri)

Data e deklarimit

Firma Personi deklarues



(1) Numri Serial: _____

(2) Periudha tatimore (viti) _____

SEKSIONI B : TË DHËNA PËR LLOGARITJEN E TATIMIT**TË ARDHURAT BRUTO**

[3] Të ardhurat bruto nga marrëdhëniet e punësimit	[3] 0
[4] Të ardhura bruto nga marrëdhëniet e ngjashme me punësimin por që nuk konsiderohen nga marrëdhëniet e punësimit	[4] 0
[5] Të ardhurat bruto nga dividendi	[5] 0
[6] Të ardhurat bruto nga qiraja	[6] 0
[7] Kthimi i investimit nga skemat e sigurimit të jetës dhe/ose pensionit privat	[7] 0
[8] Të ardhurat bruto nga interesat bankare	[8] 0
[9] Fitimi kapital i krijuar nga investimet në tituj	[9] 0
[10] Fitimi kapital i tatueshëm i krijuar nga kalimi i së drejtës së pronësisë së pasurisë së luajtshme	[10] 0
[11] Shuma bruto të fituara nga lotari apo lojra të tjera të fatit	[11] 0
[12] Të ardhurat bruto nga pasuria intelektuale, licensa, të drejta ekskluzive dhe pasuri të tjera që përbëhen vetëm nga të drejta dhe që nuk kanë formë fizike	[12] 0
[13] Fitime kapitale nga kalimi i së drejtës së pronësisë së pasurisë së paluajtshme nëpërmjet shitjes	[13] 0
[14] Fitime kapitale nga kalimi i së drejtës së pronësisë së pasurisë së paluajtshme nëpërmjet dhurimit tek trashëgimtarët ligjorë të përjashtuar nga tatimi ose deri në vlerën 5,000,000 lekë	[14] 0
[15] Fitime kapitale të tatueshme nga kalimi i së drejtës së pronësisë së pasurisë së paluajtshme nëpërmjet dhurimit	[15] 0
[16] Fitime kapitale nga kalimi i së drejtës së pronësisë së pasurisë së paluajtshme nëpërmjet trashëgimisë tek trashëgimtarët ligjorë të përjashtuar nga tatimi ose deri në vlerën 5,000,000 lekë	[16] 0
[17] Fitime kapitale të tatueshme nga kalimi i së drejtës së pronësisë së pasurisë së paluajtshme nëpërmjet trashëgimisë	[17] 0
[18] Të ardhura nga nxjerrja apo përfitimi i mjeteve virtuale	[18] 0
[19] Të ardhura nga transaksionet me mjetet virtuale	[19] 0
[20] Të ardhura bruto të tjera të papërmendura më lart të realizuara brenda territorit të Republikës së Shqipërisë	[20] 0
[21] Të ardhura bruto të realizuara jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë	[21] 0
[22] Të ardhura bruto të tjera përjashtuara nga tatimi	[22] 0
[23] SHUMA E TË ARDHURAVE BRUTO	[23] 0

SHPENZIME TË ZBRITSHME DHE ZBRITJE TË TJERA NGA TË ARDHURAT

[24] Zbritje nga të ardhurat nga punësimi sipas nenit 22, pika 1, gërmat a, b dhe c	[24] 0
[25] Shumë kompensimi për çdo fëmijë në ngarkim të tij më pak se 18 vjeç	[25] 0
[26] Shpenzime për arsimin e fëmijëve	[26] 0
[27] Zbritje për kontributin në skemën e pensionit privat nga të ardhurat e punësimit	[27] 0
[28] Zbritje për kontributin në skemën e pensioneve private nga të ardhurat e dividendit	[28] 0
[29] Zbritje për kontributin në skemën e pensioneve private nga të ardhurat tjera përveç të ardhurave nga dividendi dhe marrëdhëniet e punësimit	[29] 0
[30] SHUMA E SHPENZIMEVE TË ZBRITSHME DHE ZBRITJEVE TË TJERA	[30] 0

LLOGARITJA E TATIMIT PËR T'U PAGUAR

[31] Të ardhurat e tatueshme nga marrëdhëniet e punësimit	[31] 0
[32] Tatimi i llogaritur mbi të ardhurat e tatueshme nga marrëdhëniet e punësimit	[32] 0
[33] Të ardhurat e tatueshme nga dividendi	[33] 0
[34] Tatimi i llogaritur mbi të ardhurat e tatueshme nga dividendi	[34] 0
[35] Të ardhura të tatueshme pa të ardhurat nga dividendi dhe marrëdhëniet e punësimit	[35] 0
[36] Tatimi i llogaritur për të ardhurat e tatueshme pa të ardhurat nga punësimi dhe dividendi	[36] 0
[37] SHUMA E TATIMIT TË LLOGARITUR	[37] 0

TATIMET E PAGUARA GJATË PERIUDHËS TATIMORE

[38] Tatimi mbi të ardhurat bruto nga marrëdhëniet e punësimit	[38] 0
[39] Tatim mbi të ardhurat e ngjashme me marrëdhëniet e punësimit por që nuk konsiderohen nga marrëdhëniet e punësimit	[39] 0
[40] Tatimi mbi dividendin	[40] 0
[41] Tatimi mbi qiranë	[41] 0
[42] Tatimi mbi fitimet kapitale të realizuara nga skemat e sigurimit të jetës dhe/ose pensionit privat	[42] 0



- [43] Tatimi mbi interesat bankare
 [44] Tatimet mbi fitimet kapitale të krijuara nga investimet në tituj
 [45] Tatimet mbi fitimet kapitale të tatueshme nga kalimi i së drejtës së pronësisë së pasurisë së luajtshme
 [46] Tatimi mbi fitimet nga lotaritë apo lojrat e tjera të fatit
 [47] Tatimi mbi të ardhurat bruto nga të ardhurat nga pasuria intelektuale, licenca, të drejta ekskluzive dhe pasuri të tjera që përbëhen vetëm nga të drejta dhe që nuk kanë formë fizike
 [48] Tatimi mbi fitimet kapitale nga tjetërsimi i pasurisë së paluajtshme nëpërmjet shitjes
 [49] Tatimi mbi fitimet kapitale të tatueshme nga tjetërsimi i pasurisë së paluajtshme nëpërmjet dhurimit
 [50] Tatimi mbi fitimet kapitale të tatueshme nga tjetërsimi i pasurisë së paluajtshme nëpërmjet trashëgimisë
 [51] Tatimi mbi të ardhurat nga nxjerrja apo përfitim i mjeteve virtuale
 [52] Tatimi mbi të ardhura nga transaksionet me mjetet virtuale
 [53] Tatimi mbi të ardhura të tjera të pa përmendura më lart të realizuara brenda territorit të R. Sh.
 [54] Tatimi i llogaritur dhe i paguar mbi të ardhurat bruto të realizuara jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë
 [55] Kreditimi i tatimit të huaj
 [56] SHUMA E TATIMIT TË PAGUAR
 [57] TATIMI I MBIPAGUAR
 [58] TATIMI I DETYRUAR PËR T'U PAGUAR

[43]	0
[44]	0
[45]	0
[46]	0
[47]	0
[48]	0
[49]	0
[50]	0
[51]	0
[52]	0
[53]	0
[54]	0
[55]	0
[56]	
[57]	
[58]	

Personi Deklarues _____

Data e deklarimit _____

Firma _____

UDHËZUES I PLOTËSIMIT TË DEKLARATËS VJETORE TË TË ARDHURAVE PERSONALE

1. **Numri serial** gjenerohet nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve dhe shërben për të azhurnuar regjistrimet kur paraqitet deklarata.

2. **Periudha tatimore** është vjetore.

Seksioni A: Të dhëna identifikuese

Të dhëna identifikuese për individin

3. **Rezident në Republikën e Shqipërisë.**
Plotësohet duke vendosur shenjë X në kutinë, nëse individi është rezident në Republikën e Shqipërisë.

4. **Jorezident në Republikën e Shqipërisë.**
Plotësohet duke vendosur shenjë X në kutinë, nëse individi nuk është rezident në Republikën e Shqipërisë.

5. **Emri, atësia, mbiemri, gjinia** plotësohet me të dhënat e individit i cili deklaron me anë të kësaj deklarate, me germa kapitale.

6. **Numri i identifikimit personal sipas letërnjoftimit të deklaruesit** plotësohet sipas numrit që deklaruesi ka në dokumentin e letërnjoftimit ID-së (në kartën e identitetit, pasaportë).

7. **Adresa kryesore** plotësohet për adresën që deklaruesi ka sipas të dhënave në regjistrin e gjendjes civile.

8. **Qyteti/bashkia/rrethi** plotësohet sipas regjistrin të gjendjes civile.

9. **Statusi i deklaruesit** plotësohet duke vendosur shenjë X brenda kutive.

Të dhëna plotësuese për individin

10. **Telefon, celular, e-mail** plotësohet me numrin e telefonit, celularit dhe adresën e e-mail-it, që disponon deklaruesi.

11. **Të dhëna mbi pronësinë e banesës kryesore** plotësohet duke vendosur shenjë X, nëse banesa është në pronësi të deklaruesit me dokumente hipoteke, marrë me qira apo është dhënë falas në përdorim dhe të tjerë.

12. **Emër/mbiemër i pronarit, adresa** plotësohet për emër/mbiemrin e pronarit të banesës dhe adresën e tij, kur deklaruesi është me qira apo pronari ja ka lënë në përdorim falas e të tjerë.

Adresa e banimit nëse është e ndryshme nga adresa e të dhënave identifikuese

13. **Adresa** e banimit të deklaruesit nëse ka ndryshuar nga adresa e deklaruar në të dhënat identifikuese.

14. **Numri i telefonit, celulari, e-mail** plotësohet me numrin e telefonit, celularit dhe



adresën e *e-mail-it*, nëse ka ndryshuar, nga të dhënat identifikuese.

15. Të dhëna mbi pronësinë e banesës ku jeton plotësohet duke vendosur shenjën X, nëse banesa është në pronësi të deklaruesit, marrë me qira apo është dhënë falas.

16. Emër/mbiemër i pronarit, adresa plotësohet për emër/mbiemrin e pronarit të banesës dhe adresën e tij, kur deklaruesi është me qira apo pronari ia ka lënë në përdorim falas.

Persona në kujdestarinë e deklaruesit

17. Persona nën kujdestarinë e deklaruesit gjithsej plotësohet nga kryefamiljari, apo bashkëshortja, kur kjo është kryefamiljare, duke vënë në kuti numrin e personave brenda familjes në kujdestari dhe numrin e të tjerë personave në kutinë tjetër.

Fëmijë nën moshën 18 vjeç

18. Numri i fëmijëve në ngarkim të deklaruesit nën moshën 18 vjeç Plotësohet nga prindi që ka të ardhurat vjetore më të larta në familje.

1. Numri serial: gjenerohet nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve dhe shërben për të azhurnuar regjistrimet kur paraqitet deklarata.

2. Periudha tatimore (viti) është vjetore.

Seksioni B: Të dhëna për llogaritjen e tatimit

Të ardhurat bruto

3. Të ardhurat bruto nga marrëdhëniet e punësimit plotësohet për totalin e të ardhurave që deklaruesi përfiton nga të gjitha marrëdhëniet e punësimit gjatë periudhës tatimore sipas nenit 12 të ligjit nr. 29/2023, “Për tatim mbi të ardhurat”, i ndryshuar.

4. Të ardhura bruto nga marrëdhëniet e ngjashme me punësimin por që nuk konsiderohen nga marrëdhëniet e punësimit plotësohet për shumën e të ardhurave bruto që një individ merr nga një punëdhënësi, por që në kuptim të Kodit të punës nuk është në marrëdhënie punësimi me të, dhe punëdhënësi nuk është përgjegjës për llogaritjen e detyrimeve për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore. Të ardhurat e përfshira në këtë kategori mund të jenë, p.sh.: pjesëmarrje në borde drejtuese dhe këshillat ose trupa drejtues të tjerë, që nuk janë njëkohësisht të punësuar të subjektit pages, pagesa për performancën e aktorëve, muzikantëve ose sportistëve përfshirë pagesat ndaj personave që punësojnë artistë ose sportistë ose

veprojnë si ndërmjetës në organizimin e shfaqjeve apo performancave, pagesa me karakter jo të vazhdueshëm për shërbimet teknike, mësimdhënie, kurse, trajnime etj.

5. Të ardhurat bruto nga dividendi plotësohet për të ardhurat bruto nga dividendi.

6. Të ardhurat bruto nga qiraja plotësohet për të ardhurat bruto nga qiraja.

7. Kthimi i investimit nga skemat e sigurimit të jetës dhe/ose pensionit privat plotësohet për shumën e të ardhurave bruto (fitimet kapitale) të realizuara nga skemat e sigurimit të jetës (neni 15 i ligjit) si dhe nga investimi në skemën e pensioneve private (neni 15 i ligjit).

8. Të ardhurat bruto nga interesat bankare plotësohet për totalin e të ardhurave bruto të përfituara nga interesat bankare që individit deklarues ka përfituar, gjatë periudhës tatimore.

9. Fitimi kapital i krijuar nga investimet në tituj plotësohet për totalin e të ardhurave bruto të përfituara nga investimi në tituj që individit deklarues ka përfituar, gjatë periudhës tatimore.

10. Fitimi kapital i tatueshëm i krijuar nga kalimi i së drejtës së pronësisë së luajtshme plotësohet për totalin e fitimeve të realizuara nga individit deklarues nga kalimi i së drejtës së pronësisë mbi pasuritë e luajtshme, si në rastet kur individit e shet pasurinë e luajtshme dhe në rastet kur i dhurohet apo trashëgohet. Në rastet e shitjes së pasurisë së luajtshme, fitim kapital i tatueshëm do të plotësohet për shitjen e automjeteve, aeroplanëve dhe anijeve në qoftë se ato shiten brenda më pak se 12 muajve nga blerja. Ndërsa në rastet e trashëgimisë dhe dhurimit, fitim kapital i tatueshëm do të llogaritet nëse totali i vlerës së pasurisë së luajtshme (makinë, pikturë, vlerë monetare etj.) të përfituar nga individit për periudhën tatimore, është mbi 1 000 000 lekë dhe individit nuk është trashëgimtar ligjor sipas germës “a”, pika 7, e nenit 60 të ligjit.

11. Shuma bruto të fituara nga lotari apo lojëra të tjera të fatit plotësohet për totalin e shumave bruto të fituara nga lotaritë apo lojëra të tjera të fatit.

12. Të ardhura bruto nga pasuri intelektuale licenca, të drejta ekskluzive dhe pasuri të tjera që përbëhen vetëm nga të drejta dhe që nuk kanë formë fizike plotësohet për totalin e të ardhurave bruto nga të gjitha, sa përshkruar më sipër të cilat konsiderohen si pagesa honorare në kuptim të ligjit.



13. Fitime kapitale nga kalimi i së drejtës së pronësisë së pasurisë së paluajtshme nëpërmjet shitjes plotësohet për totalin e fitimeve të realizuara nga individit deklarues nga kalimi i së drejtës së pronësisë mbi pasuritë e paluajtshme nëpërmjet shitjes gjatë periudhës tatimore.

14. Fitime kapitale nga kalimi i së drejtës së pronësisë së pasurisë së paluajtshme nëpërmjet dhurimit të trashëgimtarët ligjorë të përjashtuar nga tatimi ose deri në vlerën 5,000,000 lekë plotësohet për totalin e fitimeve të realizuara nga individit deklarues nga kalimi i së drejtës së pronësisë mbi pasuritë e paluajtshme nëpërmjet dhurimit gjatë periudhës tatimore, vetëm në rastet kur:

a) individit përfitues është trashëgimtar ligjor në radhë të parë ose të dytë, sipas neneve 361 deri 363 të Kodit Civil, ose është brenda lidhjes gjinore motër-vëlla; ose

b) dhuratat e përfituara, përveçse dhuratave të parashikuara në germën “a”, janë deri në vlerën 5 000 000 lekë për individ.

15. Fitime kapitale të tatueshme nga kalimi i së drejtës së pronësisë së pasurisë së paluajtshme nëpërmjet dhurimit plotësohet për totalin e fitimeve të realizuara nga individit deklarues nga kalimi i së drejtës së pronësisë mbi pasuritë e paluajtshme nëpërmjet dhurimit gjatë periudhës tatimore për dhurata të cilat nuk janë të përjashtuara nga tatimi mbi të ardhurat nga dhurimi sipas ligjit.

16. Fitime kapitale nga kalimi i së drejtës së pronësisë së pasurisë së paluajtshme nëpërmjet trashëgimisë të trashëgimtarët ligjorë të përjashtuar nga tatimi ose deri në vlerën 5,000,000 lekë plotësohet për totalin e fitimeve të realizuara nga individit deklarues nga kalimi i së drejtës së pronësisë mbi pasuritë e paluajtshme nëpërmjet trashëgimisë gjatë periudhës tatimore vetëm në rastet kur:

a) individit përfitues është trashëgimtar ligjor në radhë të parë ose të dytë, sipas neneve 361 deri 363 të Kodit Civil, ose është brenda lidhjes gjinore motër-vëlla; ose

b) trashëgimia e përfituara, përveçse dhuratave të parashikuara në germën “a”, janë deri në vlerën 5 000 000 lekë për individ.

17. Fitime kapitale të tatueshme nga kalimi i së drejtës së pronësisë së pasurisë së paluajtshme nëpërmjet trashëgimisë plotësohet për totalin e fitimeve të realizuara nga individit deklarues nga kalimi i së drejtës së pronësisë mbi

pasuritë e paluajtshme nëpërmjet trashëgimisë gjatë periudhës tatimore për trashëgiminë e cila nuk është e përjashtuar nga tatimi mbi të ardhurat nga trashëgimia sipas ligjit.

18. Të ardhura nga nxjerrja apo përfitimi i mjeteve virtuale plotësohet për shumën e të ardhurave nga nxjerrja apo përfitimi i mjeteve virtuale sipas pikës 25, të nenit 3, sipas nenit 15 dhe nenit 16 të ligjit nr. 29/2023, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar.

19. Të ardhura nga transaksionet me mjetet virtuale plotësohet për shumën e të ardhurave nga transaksionet me mjetet virtuale.

20. Të ardhura bruto të tjera të papërmendura më lart të realizuara brenda territorit të Republikës së Shqipërisë plotësohet me shumën e të ardhurave bruto për çdo të ardhur tjetër e papërmendur më lart.

21. Të ardhura bruto të realizuara jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë plotësohet për shumën e të ardhurave bruto të realizuara me burim jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë sipas shkallës tatimore të përcaktuar në ligjin nr. 29/2023, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar.

22. Të ardhura bruto të tjera të përjashtuara nga tatimi plotësohet për shumën e të ardhurave bruto, të cilat sipas dispozitave të ligjit nr. 29/2023, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, nuk i nënshtrohen tatimit mbi të ardhurat personale dhe të cilat nuk janë përfshirë në rubrikat 15 dhe 17 të kësaj deklarate.

23. Shuma e të ardhurave bruto plotësohet për shumën totale të të ardhurave bruto nga rubrika [3] deri në rubrikën [22] të këtij seksioni.

Shpenzime të zbritshme dhe zbritje të tjera nga të ardhurat

24. Zbritje nga të ardhurat nga punësimi sipas nenit 22, pika 1, gjerat “a”, “b” dhe “c” tatimpaguesi i tatimit mbi të ardhurat personale me të ardhura vjetore të tatueshme nga punësimi, mund të zbresë nga baza tatimore shumën e përcaktuar në germën “a”, “b”, “c”, sipas pikës 1 të nenit 22 të ligjit nr. 29/2023, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar.

25. Shumë kompensimi për çdo fëmijë në ngarkim të tij më pak se 18 vjeç plotësohet për shumën e kompensimit për çdo fëmijë në ngarkim të tij më pak se 18 vjeç (në vlerën prej 48,000 lekë për çdo fëmijë).



26. Shpenzime për arsimin e fëmijëve plotësohet për shpenzimet për arsimin e fëmijëve në ngarkim sipas pikës 2, të nenit 22, të ligjit nr. 29/2023, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar. Këto shpenzime njihen deri në vlerën maksimale 100,000 lekë, dhe vetë në rastet kur tatimpaguesi i tatimit mbi të ardhura personale ka të ardhura të tatueshme nga punësimi më pak se 1 200 000 lekë/vit).

27. Zbritjet për kontributin në skemën e pensioneve private nga të ardhurat e punësimit plotësohet me totalin e shumës së investimit në skemën e pensioneve private nga individi deklarues punëmarrës (neni 20 i ligjit) jo më shumë se niveli i pagës minimale të miratuar në shkallë vendi.

28. Zbritjet për kontributin në skemën e pensioneve private nga të ardhurat e dividendit plotësohet me totalin e shumës së investimit në skemën e pensionit privat nga individi deklarues për të ardhurat e përfituara nga dividendi.

29. Zbritjet për kontributin në skemën e pensioneve private nga të ardhurat e tjera, përveç të ardhurave nga dividendi dhe marrëdhëniet e punësimit plotësohet me totalin e shumës së investimit në skemën e pensionit privat nga individi deklarues për të gjitha llojet e të ardhurave të tjera të përfituara përveç të ardhurave nga marrëdhëniet e punësimit dhe dividendi.

30. Shuma e shpenzimeve të zbritshme dhe zbritjeve të tjera plotësohet për shumën totale të shpenzimeve nga rubrika [24] deri në rubrikën [29].

Llogaritja e tatimit për t’u paguar

31. Të ardhurat e tatueshme nga marrëdhëniet e punësimit plotësohet për diferencën midis të ardhurave të tatueshme nga marrëdhëniet e punësimit me zbritjet nga të ardhurat nga punësimi, me shumën e kompensimit për çdo fëmijë në ngarkim të tij më pak se 18 vjeç, me shpenzimet për arsimin e fëmijëve dhe zbritjet për kontributin në skemën e pensioneve private nga të ardhurat e punësimit (rubrika [3] - [24] - [25] – [26] – [27]).

32. Tatimi i llogaritur mbi të ardhurat e tatueshme nga marrëdhëniet e punësimit plotësohet për tatimin e llogaritur për të ardhurat nga marrëdhëniet e punësimit rubrika [32] * (13% dhe 23% në varësi të bazës së tatueshme).

33. Të ardhurat e tatueshme nga dividendi plotësohet për diferencën midis të ardhurave të tatueshme bruto nga dividendi rubrika [5] me zbritjet

për kontributin në skemën e pensioneve private nga të ardhurat nga dividendit rubrika [28].

34. Tatimi i llogaritur mbi të ardhurat nga marrëdhëniet e tatueshme nga dividendi plotësohet për tatimin e llogaritur për të ardhurat nga dividendi (rubrika [33] * 8%).

35. Të ardhurat e tatueshme pa të ardhurat nga dividendi dhe marrëdhëniet e punësimit plotësohet për diferencën midis të {ardhurave të tatueshme bruto nga rubrikat [4], [6] deri në rubrikën [13], rubrikën [15] dhe rubrikat [17] deri në rubrikën [21]} me zbritjet për kontributin në skemën e pensioneve private nga të ardhurat e tjera përveç të ardhurave nga dividendi dhe marrëdhëniet e punësimit rubrika [29] .

36. Tatimi i llogaritur për të ardhurat e tatueshme pa të ardhurat nga punësimi dhe dividendi plotësohet për tatimin e llogaritur për të ardhurat e tjera pa të ardhurat nga dividendi dhe marrëdhëniet e punësimit (rubrika [35] * 15%).

37. Shuma e tatimit të llogaritur plotësohet për shumën totale të tatimit të llogaritur mbi të ardhurat e tatueshme nga marrëdhëniet e punësimit rubrika [32] me mbi të ardhurat nga marrëdhëniet e tatueshme nga dividendi rubrika [34] dhe të ardhurat e tatueshme pa të ardhurat nga punësimi dhe dividendi rubrika [36].

Tatimet e paguara gjatë periudhës tatimore

38. Tatimi mbi të ardhurat bruto nga marrëdhëniet e punësimit plotësohet për tatimin e paguar mbi të ardhurat bruto nga marrëdhëniet e punësimit, gjatë periudhës tatimore.

39. Tatimi mbi të ardhurat e ngjashme me marrëdhëniet e punësimit por që nuk konsiderohen nga marrëdhëniet e punësimit plotësohet për tatimin e paguar për shumën e të ardhurave bruto që një individ merr nga një punëdhënës, por që në kuptim të Kodit të Punës nuk është në marrëdhënie punësimi me të, dhe punëdhënësi nuk është përgjegjës për llogaritjen e detyrimeve për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore. Të ardhurat e përfshira në këtë kategori mund të jenë p.sh.: pjesëmarrje në borde drejtuese dhe këshillat ose trupa drejtues të tjerë, që nuk janë njëkohësisht të punësuar të subjektit pages, pagesa për performancën e aktorëve, muzikantëve ose sportistëve përfshirë pagesat ndaj personave që punësojnë artistë ose sportistë ose veprojnë si ndërmjetës në organizimin e shfaqjeve apo performancave, pagesa me karakter jo të



vazhdueshëm për shërbimet teknike, mësimdhënie, kurse, trajnime etj.

40. Tatimi mbi dividendin plotësohet për tatimin e paguar mbi të ardhurat bruto nga dividendi gjatë periudhës tatimore.

41. Tatimi mbi qiranë plotësohet për tatimin e paguar mbi të ardhurat bruto nga qiraja gjatë periudhës tatimore.

42. Tatimi mbi fitimet kapitale të realizuara nga skemat e sigurimit të jetës dhe ose pensionit privat plotësohet për tatimin e paguar për shumën e të ardhurat bruto (fitimet kapitale) të realizuara nga skemat e sigurimit të jetës (neni 15 i ligjit), si dhe nga investimi në skemën e pensioneve private (neni 15 i ligjit).

43. Tatimi mbi interesat bankarë plotësohet për tatimin e paguar për të ardhurat bruto nga interesat bankarë gjatë periudhës tatimore.

44. Tatimet mbi fitimet kapitale të krijuara nga investimet në tituj plotësohet për tatimin e paguar nga fitimi kapital i krijuar nga investimet në tituj gjatë periudhës tatimore.

45. Tatimi mbi fitimet kapitale të tatueshme nga kalimi i së drejtës së pronësisë së pasurisë së luajtshme plotësohet për tatimin e paguar mbi fitimet kapitale nga tjetërsimi i pasurisë së luajtshme gjatë periudhës tatimore.

46. Tatimi mbi fitimet nga lotaritë apo lojërat e tjera të fatit plotësohet për tatimin e paguar për shumën bruto të fituara nga lotari apo lojëra të tjera të fatit gjatë periudhës tatimore.

47. Tatimi mbi të ardhurat bruto nga të ardhurat nga pasuria intelektuale, licenca, të drejta ekskluzive dhe pasuri të tjera që përbëhen vetëm nga të drejta që nuk kanë formë fizike plotësohet për tatimin e paguar për shumën bruto mbi të ardhurat nga pasuria intelektuale, licenca, të drejta ekskluzive dhe pasuri të tjera që përbëhen vetëm nga të drejta që nuk kanë formë fizike.

48. Tatimi mbi fitimet kapitale nga tjetërsimi i pasurisë së paluajtshme nëpërmjet shitjes plotësohet për tatimin e paguar për fitimet kapitale nga kalimi i së drejtës së pronësisë së pasurisë së paluajtshme nëpërmjet shitjes.

49. Tatimi mbi fitimet kapitale të tatueshme nga tjetërsimi i pasurisë së paluajtshme nëpërmjet dhurimit plotësohet për tatimin e paguar për fitimet kapitale nga kalimi i së drejtës së

pronësisë së pasurisë së paluajtshme nëpërmjet dhurimit.

50. Tatimi mbi fitimet kapitale të tatueshme nga tjetërsimi i pasurisë së paluajtshme nëpërmjet trashëgimisë plotësohet për tatimin e paguar për fitimet kapitale nga kalimi i së drejtës së pronësisë së pasurisë së paluajtshme nëpërmjet trashëgimisë.

51. Tatimi mbi të ardhurat nga nxjerrja apo përfitimi i mjeteve virtuale plotësohet për tatimin e paguar mbi të ardhurat nga nxjerrja apo përfitimi i mjeteve virtuale gjatë periudhës tatimore.

52. Tatimi mbi të ardhura nga transaksionet me mjetet virtuale plotësohet për tatimin e paguar mbi të ardhurat nga transaksionet me mjetet virtuale.

53. Tatimi mbi të ardhura të tjera të papërmendura më lart, të realizuara brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, plotësohet për tatimin e paguar për të ardhurat bruto për interesat e tjerë, pagesat me një shumë të vetme nga punëdhënësi në rastet e ristrukturimeve, largimeve nga puna apo vendimet e gjykatës, si dhe çdo e ardhur tjetër e pa përmendur më lart.

54. Tatimi i llogaritur dhe i paguar mbi të ardhurat bruto të realizuara jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë plotësohet për tatimin e paguar për të ardhurat bruto të realizuara jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

55. Kreditimi i tatimit të huaj nëse gjatë një viti tatimor tatimpaguesi rezident i tatimit mbi të ardhurat personale realizon të ardhura tatimore nga burime jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, tatimit për t'u paguar nga ai tatimpagues për këto të ardhura duhet t'i zbritet shumën e tatimit të paguar në një vend të huaj mbi këto të ardhura deri në shkallën tatimore të përcaktuar në ligjin nr. 29/2023, "Për tatimin mbi të ardhurat".

56. Shuma e tatimit të paguar plotësohet për shumën e tatimit të paguar gjatë periudhës tatimore, duke mbledhur rubrikat [38] deri në rubrikën [53] + rubrikën [55].

57. Tatimi i mbipaguar plotësohet për shumën e tatimit të mbipaguar gjatë periudhës tatimore (rubrika [56]–rubrika [37], kur rubrika [56]> rubrika [37]).

58. Tatimi i detyruar për t'u paguar plotësohet për shumën e tatimit për t'u paguar për periudhën tatimore (rubrika [37]–rubrika [56], kur rubrika [37]> rubrika [56]).



UDHËZIM
Nr. 25, datë 11.11.2025

PËR MËNYRAT DHE PROCEDURAT
PËR RAPORTIM NGA ORGANET
DOGANORE

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës dhe të nenit 28, pika 3, germa “b”, të ligjit nr. 9917, datë 19.5.2008, “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, të ndryshuar, ministri i Financave,

UDHËZON:

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i këtij udhëzimi është përcaktimi i mënyrave dhe procedurave të raportimit nga organet doganore, si dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet Drejtorisë të Përgjithshme të Doganave dhe Agjencisë së Inteligjencës Financiare.

Neni 2
Përkufizimet

1. Termat e përdorur në këtë udhëzim kanë të njëjtin kuptim me termat e përkufizuar në nenin 2 të ligjit nr. 9917, datë 19.5.2008, “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, të ndryshuar.

2. Përveç sa parashikohet në pikën 1 të këtij neni, për qëllim dhe zbatim të këtij udhëzimi, termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

3. “Raporti i transportimit të vlerave në kufi (RTVK)” është formulari i deklarimit që plotësohet nga çdo person, në përputhje me përcaktimet e pikës 1, të nenit 17/1, të ligjit nr. 9917, datë 19.5.2008, “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, të ndryshuar. Formulari plotësohet sipas aneksit I dhe instruksioneve pjesë e këtij aneksi, bashkëlidhur dhe pjesë e këtij udhëzimi.

4. “Raporti i aktivitetit të dyshimtë (RAD)” është formulari që plotësohet për çdo dyshim, sipas aneksit II dhe instruksioneve pjesë e këtij aneksi, bashkëlidhur dhe pjesë e këtij udhëzimi, dhe i dërgohet autoritetit përgjegjës.

5. “Treguesit e aktivitetit të dyshimtë të pastrimit

të parave dhe financimit të terrorizmit” janë përmbledhur në aneksin III, bashkëlidhur dhe pjesë e këtij udhëzimi.

Neni 3
Raportimi i organeve doganore

1. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave raporton në Agjencinë e Inteligjencës Financiare në rrugë elektronike, RTVK-të e administruara nga autoritetet doganore, së bashku me dokumentet shoqëruese apo të dhëna të tjera shtesë për rastin, brenda ditës pasardhëse të punës, nëpërmjet aksesit në sistemin *online*.

2. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave raporton në Agjencinë e Inteligjencës Financiare menjëherë, dhe jo më vonë se 72 orë, çdo dyshim, informacion ose të dhënë, që kanë lidhje me pastrim parash ose financim terrorizmi, për veprimtaritë nën juridiksionin e tyre, sipas formularit të RAD, të shoqëruar me të gjithë dokumentacionin mbështetës për rastin. Depozitimi/raportimi në Agjencinë e Inteligjencës Financiare bëhet në rrugë shkresore dhe elektronike deri në momentin që do të kalohet në aksesin *online*.

Neni 4
Dokumentacioni dhe ruajtja e tyre

1. Organet doganore pranojnë nga personi, apo përfaqësuesi, i cili hyn në/ose largohet nga territori i Republikës së Shqipërisë, sipas përcaktimeve të këtij neni, vetëm dokumente origjinale, fotokopje të noterizuara, apo dokumente elektronik që plotësojnë kushtet e vlefshmërisë, sipas legjislacionit shqiptar në fuqi për dokumentin elektronik ose nënshkrimin elektronik.

2. Organet doganore, kur e gjykojnë të nevojshme, duhet të kërkojnë paraqitjen nga personi, apo përfaqësuesi, i cili hyn në/ose largohet nga territori i Republikës së Shqipërisë të dokumenteve të tjera justifikues për verifikimin e të dhënave të paraqitura prej këtij të fundit dhe ruan kopje të tyre.



Neni 5

Masat organizative të ndërmarra nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave

1. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave administron një sistem të centralizuar përgjegjës për grumbullimin dhe analizimin e të dhënave, në funksion të përmbushjes së detyrimeve të këtij udhëzimi. Për këtë qëllim, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave ngarkon një strukturë qendrore, përgjegjëse për identifikimin dhe mbledhjen e transaksioneve të dyshimta.

2. Drejtori i Drejtorisë të Përgjithshme të Doganave cakton një person përgjegjës me pozitë drejtuese i cili shërben si person kontakti me Agjencinë e Inteligjencës Financiare, si dhe person/a përgjegjës në çdo degë doganore, të cilat shërbejnë si pika kontakti me personin përgjegjës në Drejtorinë e Përgjithshme e Doganave.

3. Drejtuesi i strukturës qendrore raporton drejtpërdrejtë te drejtori i përgjithshëm i Drejtorisë të Përgjithshme të Doganave apo pranë personit të autorizuar prej tij.

4. Struktura qendrore ka këto kompetenca dhe detyra:

a) organizon procesin e monitorimit dhe siguron kryerjen e detyrave të përcaktuara nga ligji për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;

b) analizon çdo të dhënë apo informacion që është njoftuar si e dyshimtë, apo ka konstatuar përmes punonjësve të vet, në funksion të dërgimit të RAD-së në Agjencinë e Inteligjencës Financiare;

c) nëse informacioni vlerësohet si i dyshimtë, personi përgjegjës dërgon RAD-në në Agjencinë e Inteligjencës Financiare;

d) organizon trajnime periodike për strukturat përkatëse në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, sipas profilit të tyre të punës, në lidhje me detyrimet ligjore në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, si dhe tipologjitë përkatëse që lidhen me këto fusha;

e) përgatit raportet me shkrim të paktën një herë në vit për detyrimet e mësipërme (duke përfshirë numrin e raporteve të dyshimta të identifikuar, tipologjitë e tyre apo të dhëna të tjera që çmohen me interes) dhe ia dorëzon atë drejtorit të përgjithshëm të Drejtorisë të Përgjithshme të Doganave.

5. Struktura qendrore në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave ka akses në çdo

informacion të nevojshëm që disponon Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për të përmbushur funksionet e saj, duke ruajtur konfidencialitetin për natyrën e aktiviteteve të kryera.

6. Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë të Përgjithshme të Doganave ngarkon kontrollin e brendshëm, apo struktura të tjera të përshtatshme, për të kontrolluar përputhshmërinë e punonjësve në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, lidhur me detyrimet e këtij udhëzimi.

Neni 6

Shkëmbimi i informacionit

1. Informacioni i shkëmbyer ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe Agjencisë të Inteligjencës Financiare kryhet mbi bazat e konfidencialitetit reciprok.

2. Kur Agjencia e Inteligjencës Financiare ka bllokuar ose përgatitet të bllokojë një transaksion për 72 orë dhe kërkon informacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, ky informacion duhet t'i vihet në dispozicion brenda 48 orëve. Kjo kërkesë e arsyetuar mund të bëhet me shkresë ose elektronikisht. Çdo kërkesë elektronike duhet të dokumentohet me shkresë brenda tri ditësh pune.

3. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, në zbatim të nenit 22, germa "b", të ligjit nr. 9917, datë 19.5.2008, të ndryshuar, i ofron Agjencisë të Inteligjencës Financiare akses në bazën e të dhënave *Aycuda World*. Modalitetet dhe specifikimet teknike në funksion të këtij aksesit përcaktohen në marrëveshje të lidhur për këtë qëllim mes Drejtorisë të Përgjithshme të Doganave, Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë të Informacionit dhe Agjencisë të Inteligjencës Financiare.

Neni 7

Kërkesa për mosdeklarim

Punonjësve të Drejtorisë të Përgjithshme të Doganave u ndalohet të informojnë çdo individ, person fizik apo juridik për dërgimin apo përgatitjen për dërgim të informacionit për Agjencinë e Inteligjencës Financiare, RAD apo çdo informacion që kërkohet nga Agjencia e Inteligjencës Financiare apo për hetimet, verifikimet që janë duke u kryer.



Neni 8
Dispozita të fundit

1. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe Agjencia e Inteligjencës Financiare ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi dhe anekseve si pjesë organike e tij:

a) Aneksi I, “Raporti i transportimit të vlerave në kufi” (RTVK) bashkë me “Instruksionet për plotësimin e formularit RTVK”;

b) Aneksi II, “Raporti i aktivitetit të dyshimtë” (RAD) bashkë me “Instruksionet për plotësimin e formularit RAD”;

c) Aneksi III, “Treguesit e aktivitetit të dyshimtë të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”.

2. Udhëzimi nr. 15 datë 16.2.2009, “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftës për financimin e terrorizmit në sistemin doganor”, shfuqizohet.

3. Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCAVE

Petrit Malaj

ANEKSI I
RAPORTI I TRANSPORTIMIT TË VLERAVE NË KUFİ (RTVK)

1. Tipi i deklarates		2.Nr. Regjistrimit të formularit të deklarimit b. Nr. Regjistrimi a. Data e mandatit të	
FORMULARI DEKLARIMIT			
PJESA I: Të dhëna personale			
3. Detajet e Deklaruesit Gjinia		Dokument Identifikimi: Pasaporta/Kartë ID Vendi i lëshimit (qyteti) Numri Personal / BSN	
a. Mbiemri b. Emri c. Data & Vendi d. Kombësia e. Adresa f. Kodi Postar / Qyteti g. Shteti		Data e lëshimit h. Profesioni:	
4. A jeni ju zotëruesi?		5. Detajet e zotëruetit	
a. Mbiemri b. Emri c. Data & Vendi i d. Kombësia e. Adresa f. Kodi Postar / Qyteti g. Shteti		h. Emri i Kompanisë i. Nr. NIPT j. Adresa k. Kodi Postar / Qyteti l. Shteti:	
PJESA II: Lloji i monedhës ose instrumentave monetare			
6. Instrumentat monetarë	Tjetër	Shuma	7. Monedha
			8. Ekuivalente në
TOTALI			
PJESA III: Origjina dhe qëllimi i përdorimit të parave dhe instrumentave monetare			
9. Origjina			
10. Qëllimi i përdorimit			
11. A jeni ju marrësi		12. Detajet e marrësit	
a. Mbiemri b. Emri c. Data & Vendi d. Kombësia e. Adresa f. Kodi Postar / Qyteti g. Shteti		h. Emri i Kompanisë i. Nr. NIPT j. Adresa k. Kodi Postar / Qyteti l. Shteti:	
PJESA IV: TË DHËNA PËR TRANSPORTIN			
13. Mënyra			
14. Itinerari		15. Kompania	
a. Vendi i Nisjes	c. Njëpërmjet (Vendi)	e. Vendi i Destinacionit	
b. Data e Nisjes	d. Data e Nisjes	f. Data e Mbërritjes	
16. Nr. References		17. Firma e Deklaruesit	
		Firma & Vula e Doganës	
		18. Shënime Doganore	
Data			



**INSTRUKSIONE
PËR PLOTËSIMIN E FORMULARIT PËR
RAPORTIMIN E TRANSPORTIMIT TË
VLERAVE NË KUFİ (RTVK) PËR VLERA,
DUKE FILLUAR NGA SHUMA
10 000 EURO**

Organet doganore duhet të zbatojnë të gjitha detyrimet që rrjedhin nga ligji nr. 9917, datë 19.5.2008, “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, të ndryshuar.

KUSH DUHET TA PLOTËSOJË FORMULARIN?

Çdo person, banues ose jo në Shqipëri, i cili hyn në/ose largohet nga territori i Republikës së Shqipërisë, përfaqësuesit e personave që hyjnë në/ose largohen nga territori i Republikës së Shqipërisë në rrugë tokësore, ajrore ose detare apo dhe nëpërmjet shërbimit postar, të cilët janë subjekt i deklarimit të shumave në të holla, çdo lloj instrumenti të negociueshëm, metaleve ose gurët e çmuar, sendeve me vlerë dhe objekteve antike, duhet të plotësojnë “Formularin për raportimin e transportimit të vlerave në kufi (RTVK) për vlera, duke filluar nga shuma 10 000 euro”. Formulari gjendet në faqen zyrtare të Doganës.

ÇFARË KONSIDEROHET “PARA FIZIKE”?

“Para fizike” janë monedhat (kartëmonedhat dhe monedhat metalike, kombëtare dhe të huaja) në qarkullim.

ÇFARË KONSIDEROHEN “INSTRUMENTE TË NEGOCIUESHME TË MBAJTËSIT”?

“Instrumente të negociueshme të mbajtësit” përfshijnë instrumentet monetare në formën e mbajtësit në pronësi të këtij të fundit, të tilla si çeqet e udhëtarit; instrumentet e negociueshme (ku përfshihen, por pa u kufizuar në çeqet, premtimpagesat dhe urdhërpagesat), që janë në formën e mbajtësit, të vlefshme, pa u kufizuar nga personi të cilit i paguhet, të paguara një personi fiktiv ose përndryshe në një formë që pronësia kalohet thjesht nëpërmjet dorëzimit nga një person tek një tjetër; instrumentet jo të plota (përfshirë, por pa u kufizuar në çeqet, premtimpagesat dhe urdhërpagesat), të nënshkruara, por pa përfshirë emrin e personin të cilit i paguhet.

KUR DHE KU DORËZOHET RAPORTI?

Autoritetet doganore duhet të dërgojnë pranë Agjencisë të Inteligjencës Financiare, kopje të

formularëve të deklarimit dhe të dokumenteve justifikuese të paraqitura nga deklaruesit.

KUJDES!

Duhet plotësuar çdo pjesë e formularit me të dhëna të detajuara dhe të sakta!

Plotësimi i detajuar i formularit R TVK:

A. **Zyra Doganore** → zgjidhet dega/pika doganore në të cilën subjekti do të bëjë deklarimin në territorin e Republikës së Shqipërisë;

1. **Tipi i deklarates** → zgjidhet në varësi nëse është hyrje apo dalje në/nga Republika e Shqipërisë;

2. **Nr. i regjistrimit të formularit të deklarimit** → nuk plotësohet nga personi/ subjekti por do të gjenerohet automatikisht në momentin kur punonjësi i degës doganore kufitare do të kryejë hedhjen në sistem të të dhënave.

1.Pjesa I. Të dhëna personale (siç janë në dokumentin e identifikimit)

3. **Detajet e deklaruesit, Gjinia** → zgjidhet F/M (Femër/Mashkull);

a) **Mbiemri** → vendoset mbiemri i individit që paraqitet pranë organeve doganore për të kryer deklarimin;

b) **Emri** → vendoset emri i individit që paraqitet pranë organeve doganore për të kryer deklarimin;

c) **Datëlindja dhe vendi i lindjes** → vendoset data e lindjes e personit të sipërcituar manualisht në formatin DD.MM.VVVV;

d) **Kombësia** → vendoset kombësia e deklaruesit;

e) **Adresa** → vendoset adresa e deklaruesit;

f) **Kodi postar/qyteti** → vendoset kodi postar dhe qyteti;

g) **Shteti** → vendoset shtetësia e deklaruesit;

- **Dokument identifikimi** → vendoset lloji i dokumentit të identifikimit të paraqitur nga deklaruesi;

- **Pasaporte/kartë identiteti** → vendoset numri pasaportës apo kartës së identitetit, p.sh. BJXXXXX apo E1 l llllllD;

- **Data e lëshimit** → vendoset data e lëshimit të dokumentit të identifikimit;

- **Vendi i lëshimit** (qyteti, shteti) →+ vendoset vendi i lëshimit të dokumentit të identifikimit;

- **Nr. personal** → A1 111111 A;

h) **Profesioni** → kërkohet profesioni i deklaruesit.

4. **A jeni ju zotëruesi?** → në të cilën duhet të përzgjidhet sipas rastit:



- PO., nëse individ (deklaruesi) është dhe zotërues i parave apo çdo lloj instrumenti tjetër të negociushëm që deklarohet, → shko te pjesa II (pika 6) për të vijuar me zgjedhjen e llojit të monedhës apo instrumentit të negociushëm;

- JO..., nëse individ (deklaruesi) nuk është zotërues i parave apo çdo lloj instrumenti tjetër të negociushëm që deklarohet, por deklaron në emër dhe për llogari të një personi tjetër (fizik apo juridik) → **plotësim i detyrueshëm i pikës 5;**

5. Detajet e zotëruesit → zgjidh person fizik (individ) apo juridik sipas rastit;

KUJDES! Pika 5 plotësohet nëse në pikën 4 kemi përzgjedhur opsionin JO dhe të dhënat e kërkuara në këtë pikë do të plotësohen për personin (fizik apo juridik) për llogari të të cilit po kryhet ky deklaram.

- nëse zgjidhet person fizik plotëso të dhënat nga germa “a” deri tek germa “g” (për plotësim referohu pikës 3);

- nëse zgjidhet person juridik plotëso të dhënat nga germa “h” deri tek germa “i” e pikës 5.

2.Pjesa II. Lloji i monedhës ose instrumenteve monetare

6. Instrumentet monetare → Zgjidhet nëse janë para *cash*, sende apo gurë të çmuar etj.;

7. Monedha → vendos kodin e monedhës në varësi të llojit të monedhës së deklaruar;

8. Ekuivalenti → nuk plotësohet nga deklaruesi pasi konvertimi kryhet automatikisht nga sistemi në momentin që punonjësi i doganës e regjistron në sistemin informatik *ASYCUDA World*.

3.Pjesa III. Origjina dhe qëllimi i përdorimit të parasë dhe instrumenteve monetare

9. Origjina → Vendoset burimi i të ardhurave të deklaruara në pikën 6;

10. Qëllimi i përdorimit → Vendoset qëllimi final i përdorimit të instrumenteve financiar të deklaruar/ parave dhe sendeve me vlerë;

11. A jeni ju marrësi përfundimtar → në të cilën duhet të përzgjidhet sipas rastit:

- Po → nëse deklaruesi është dhe marrësi përfundimtar → më pas kalohet në plotësimin e pjesës IV-pika 13;

- Jo → nëse deklaruesi nuk është marrësi përfundimtar → *Plotësim i detyrueshëm i pikës 12;*

12. Detajet e marrësit → zgjidh sipas rastit një nga opsionet (për plotësim referohu pikës 5 më lart përmendur);

- nëse zgjidhet person fizik (individ) plotëso të dhënat për të nga germa “a” deri tek germa “g”;

- nëse zgjidhet person juridik plotëso të dhënat nga germa “h” deri tek germa “i”.

Pjesa IV. Të dhëna për transportin

13. Mënyra e transportit → zgjidhet njëra nga mënyrat e transportit (ajrore/tokësore/detare);

14. Itinerari → plotëso të dhënat mbi: a) vendin e nisjes; b) datën e nisjes; c) vendin e transitit (nëse ka); d) datën e nisjes (së transitit); e) vendin e destinacionit; d) datën e mbërritjes;

15. Kompania transportuese → nuk plotësohet nga individ;

16. Nr. i referencës → nuk plotësohet nga individ;

17. Firma e deklaruesit → Emër Mbiemër, firmë e deklaruesit, si dhe firma dhe vula e punonjësit të doganës;

18. Shënime doganore → për t’u plotësuar nga punonjësit doganorë; në rast mosdeklarimi autoritetet doganore shënojnë “deklarim jo vullnetar”.



ANEKSI II RAPORTI I AKTIVITETIT TË DYSHIMTË (RAD)

1. Zgjidhni kutin me kombinime:	
☐ Pastrim parash	☐ Financim i terrorizmit ☐ Fonde që rrjedhin nga veprimtari kriminale
2. Zgjidhni kutinë me kombinime:	
☐ Raport i ri;	☐ Raportimet te lidhura ☐ Përmirëson një raport të mëparshëm
PJESA I. INFORMACION MBI AKTIVITETIN E DYSHIMTË	
1. Statusi ligjor i personit: a. ☐ Individ b. ☐ Person fizik tregtar c. ☐ Person juridik; ☐ Shoqëri Anonime f. ☐ OJF g. ☐ Organizime Ligjore ☐ SHPK (Shoqëri me përgjegjësi te kufizuar) i. ☐ Kujdestar; j. ☐ Dege e shoqërisë së huaj k. ☐ PEP l. ☐ SHKK m. ☐ Tjetër 2. a) Emri: _____ b. Atësia ¹ : _____ c. Mbiemri: _____ 3. Datëlindja/data e regjistrimit: _____. _____. _____ 4. Shtetësia: a. ☐ Shqiptar b. ☐ I huaj 5. Vendlindja: _____ 6. Adresa/Vendbanimi: _____ 7. Gjinia : a Mashkull ☐ b. Femër ☐	
8. Dokumenti i identifikimit: a) ☐ Letërnjoftim b) ☐ Pasaportë 9. Numri i dokumentit: _____ 10. Nr. Personal i identifikimit (NID): _____ 11. Autoriteti lëshues: _____	
12. Emërtimi i Subjektit: _____ 13. NUIS/NIPT: _____ 14. Adresa e themelimit: _____ 15. Adresa e përkohshme (nëse ka): _____ 16. Punësim/lloji i aktivitetit: _____ 17. Nëse është PEP: ☐	
PJESA II. PERSONAT E PËRFSHIRË	
PJESA III. VEPRIMI FINANCIAR I KRYER	
1. Numri i transaksioneve: _____ 2. Numri i llogarisë/ve: _____ 3. Data e transaksionit: _____. _____. _____ 4. Monedha: Lek ☐ Euro ☐ USD ☐ GBP ☐ JPY ☐ CHF ☐ CAD ☐ Tjetër 5. Shuma e transaksionit: _____	
PJESA IV. SHPJEGIME/PËRSHKRIME TË AKTIVITET TË DYSHIMTË:	
Shpjegime/përshkrime të aktivitetit të dyshimtë: <i>Shënim: Të strukturohet në disa pika</i> 1. përshkrimi i profilit të subjektit të RAD; 2. analiza totale e rastit duke përfshirë dhe analizë të historikut të transaksioneve; 3. anomali të vërejtura në transaksion, veprime apo veprimtari të dyshimta; 4. dyshimet për rastin; 5. lidhje me raste të tjera të raportuara të dyshimta, nëse ka; 6. nëse kërkohen udhëzime nga AIF; 7. të dhëna apo informacione të tjera me interes.	

¹ Atësia kur deklarohet



PJESA V. LISTA E DOKUMENTEVE SHOQËRUESE:	
PJESA VI. INFORMACION MBI SUBJEKTIN RAPORTUES:	
Emri: _____	Data e raportimit: ____ . ____ . ____
Personi përgjegjës: _____	Tel. _____
Firma: _____	E-mail. _____
Aprovuesi: _____	Adresa: _____

INSTRUKSIONE PËR PLOTËSIMIN E FORMULARIT TË RAPORTIMIT TË AKTIVITETIT TË DYSHIMTË (RAD) NGA ORGANET DOGANORE

HYRJE

Ky instruksion jepet për të ndihmuar organet doganore për të plotësuar formularin e raportimit të aktivitetit të dyshimtë. Ky formular do të raportohet pranë Agjencisë të Inteligjencës Financiare në rrugë elektronike.

1. Shënohet një kryq në kutinë përkatëse sipas rastit nëse aktiviteti dyshohet se ka të bëjë me pastrim parash, financim të terrorizmit apo fondet rrjedhin nga veprimtari kriminale.

2. Shënohet një kryq në kutinë përkatëse sipas rastit nëse dërgohet pranë Agjencisë të Inteligjencës Financiare, një raport i ri apo bëhet përmirësim i një raporti të mëparshëm.

PJESA I. INFORMACION MBI AKTIVITETIN E DYSHIMTË

1. Statusi ligjor i personit: Me anë të zgjedhjes së një prej kutive, subjekti raportues jep informacion për statusin ligjor të personit/ave të përfshirë në aktivitetin e dyshimtë sipas rastit individ, person fizik tregtar, person juridik, shoqëri anonime, OJF, organizime ligjore, SHPK (shoqëri me përgjegjësi të kufizuar), kujdestar, SHKK apo degë e shoqërisë së huaj.

2. Emri Mbiemri: për individin shkruhen emri dhe mbiemri. Atësia plotësohet kur deklarohet.

3. Datëlindja/ data e regjistrimit (dd.mm.vvvv): nëse personi në emër të të cilit kryhet transaksioni/et është individ, shkruani datën e lindjes, përndryshe shkruhet data e regjistrimit të shoqërisë. Data shkruhet në formatin tetëshifror. Dy shifrat e para tregojnë datën kalendarike të muajit, dy

të dytat tregojnë muajin kalendarik dhe katër të fundit tregojnë vitin e lindjes. Zero (0) duhet t'i paraprijë çdo shifre teke. P.sh. nëse data e lindjes së një individi është 3 prill 1978, në raport duhet të shkruhet në formatin 3.4.1978.

4. Shtetësia: shkruhet shtetësia e personit që kryen transaksionin (plotësohet në rastin e personave fizikë).

5. Vendlindja: shkruhet vendi (juridiksioni) ku personi ka lindur;

6. Adresa/vendbanimi i përhershëm: shkruhet adresa që deklarohet nga subjekti apo evidentohet në dokumentet e paraqitura prej tij.

7. Gjinia: a) Mashkull; b) Femër: shënohet një kryq në kutinë përkatëse sipas rastit, nëse individi është mashkull apo femër.

8. Dokumenti i identifikimit: a) ☐ letërnjoftim; b) ☐ pasaportë. Shënohet një kryq në kutinë përkatëse sipas llojit të dokumentit të përdorur për të bërë identifikimin e personit.

9. Numri i dokumentit: këtu shkruhet numri i dokumentit të përdorur për identifikim.

10. Numri personal i identifikimit (NID): këtu shkruhet numri personal i identifikimit.

11. Autoriteti lëshues: këtu shkruhet autoriteti shtetëror që ka lëshuar dokumentin e përdorur për të bërë identifikimin e personit.

12. Emërtimi i subjektit: këtu shkruhet emri i subjektit.

13. NUIS/NIPT: shkruhen numri unik i identifikimit të subjektit ose numri i identifikimit të personit të tatueshëm.

14. Adresa e themelimit: plotësohet vendi i selisë të themelimit të klientit sipas dokumenteve të paraqitura prej tij.



15. Adresa e përkohshme (nëse ka): plotësohet nëse personi ka një vend veprimtarie të ndryshëm nga adresa e themelimit.

16. Punësim/lloji i aktivitetit: jepet përshkrimi i punësimit ose llojit të aktivitetit të personit të përfshirë në aktivitetin e dyshimtë.

17. Nëse është PEP: shënohet një kryq në kutinë përkatëse nëse subjekti është person i ekspozuar politikisht.

PJESA II. PERSONAT E PËRFSHIRË

Në këtë pjesë të raportit jepen të dhënat mbi personat e përfshirë në transaksion.

PJESA III. VEPRIMI FINANCIAR I KRYER

1. Numri i transaksioneve: shkruhet numri i transaksioneve të kryera apo të tentuara.

2. Numri i llogarisë/ve: shkruhen numri/at e llogarive të përfshira në aktivitetin e dyshimtë.

3. Data e kryerjes së transaksionit: data e transaksionit shkruhet në formatin tetë shifror. Dy shifrat e para tregojnë datën kalendarike të muajit, dy të dytat tregojnë muajin kalendari dhe katër të fundit tregojnë vitin. Zeroja (0) duhet t'i paraprijë çdo shifre teke. P.sh. nëse data e transaksionit është 5 maj 2008, në raport duhet të shkruhet 5.5.2008.

4. Monedha: vihet një kryq në një prej kutive sipas llojit të monedhës së përdorur për kryerjen e transaksionit p.sh.: LEK, USD, GBP, EUR etj.

5. Shuma e transaksionit: shkruhet shuma për transaksion të vetëm ose për disa transaksione të lidhur me njëra-tjetrën.

PJESA IV. SHPJEGIME/PËRSHKRIME TË AKTIVITETIT TË DYSHIMTË

Ky seksion i raportit është shumë i rëndësishëm. Kujdesi dhe një analizë paraprake e organeve doganore mund të ndikojë dhe orientojë drejt në të kuptuarit e saktë të sjelljes së përshkruar dhe aktivitetit të dyshimtë të raportuar. Në këtë seksion duhet përshkruar periudha e aktivitetit të dyshimtë. Nëse kemi të bëjmë vetëm me një transaksion të dyshimtë duhet dhënë data e këtij transaksioni. Një shpjegim i qartë duhet të ekzistojë edhe për shumat e përfshira në aktivitetin apo transaksionin e dyshimtë. Te përshkrimi i rastit të dyshimtë të përshkruhet në mënyrë të hollësishme transaksioni i kryer me çdo detaj, si dhe arsyeja e dyshimit. Në rastet kur kemi shumë transaksione të përshkruhet në mënyrë të hollësishme e gjithë kronologjia e rrjedhjes së veprimeve, si dhe shumat përkatëse të transaksioneve. Në këtë seksion duhet përfshirë çdo

informacion që besohet se është i nevojshëm për të kuptuar dhe ndihmuar investiguesit në analizimin e aktivitetit të dyshimtë. Bashkëngjitur raportimit të aktivitetit të dyshimtë është e nevojshme të bashkëlidhen edhe informacione shtesë lidhur me subjektin. Nëse organet doganore, për përfaqësuesit ligjorë, ortakët, administratorët, aksionarët e subjektit tregtar të raportuar për aktivitet të dyshimtë disponojnë informacion që janë persona të lidhur apo kanë interesa në subjekte të tjera tregtare, ky informacion duhet t'i bashkëlidhet aneksit

PJESA V. LISTA E DOKUMENTEVE SHOQËRUESE

Në këtë pjesë të raportit vendosen të zipuara (deri në 10.MB ZIP) dokumentet që shoqërojnë raportin.

PJESA VI. INFORMACION MBI SUBJEKTIN RAPORTUES

Te kjo rubrikë duhet të shënoni të dhënat për subjektin raportues, organin doganor, ku të plotësohen emri, mbiemri, si dhe pozicioni i punonjësit që ka plotësuar këtë formular, adresa dhe numri i telefonit i organit doganor, si dhe data e raportimit nga ky autoritet.

ANEKS III

TREGUESIT E AKTIVITETIT TË DYSHIMTË TË PASTRIMIT TË PARAVE DHE FINANCIMIT TË TERRORIZMIT

a) Indikatorët kryesore të riskut në sistemin doganor janë:

- **Shumat e mëdha të parave të padeklaruara** – Kur individët ose kompanitë përpiqen të hyjnë ose të dalin nga vendi me sasi të mëdha parash ose valutash pa i deklaruar në doganë.

- **Transferimet e shpeshta dhe në vlera të larta** – Transaksionet e shpeshta ndërkufitare të mallrave ose të parave që nuk kanë një qëllim të qartë ekonomik ose justifikim logjik.

- **Ndryshimet e papritura në modelet e tregtisë** – Përfshirja e papritur e kompanive ose individëve në tregti me vende ose mallra që nuk janë pjesë e aktivitetit të zakonshëm të tyre.

- **Veprimtari të dyshimta në tregti** – Tregtia e mallrave të cilat janë shpesh të lidhura me aktivitete kriminale, si ato që lidhen me substanca narkotike, armë, apo mallrat e ndaluara.

- **Mungesa e dokumentacionit të mjaftueshëm** – Kur mallrat që kalojnë kufirin nuk



shoqërohen me dokumentacionin e duhur, përfshirë faturat, licencat, apo certifikatat e origjinës.

- **Vlera të pajustificuara të deklarimit të mallrave** – Kur ekziston një diferencë e madhe ndërmjet vlerës të deklaruar dhe vlerës reale të mallrave, për të shmangur tarifatat doganore ose për të fshehur burimet e fondeve.

- **Përdorimi i paligjshëm i përfituesve të tretë** – Përdorimi i kompanive ose i individëve të tretë si përfitues formal të mallrave, apo fondeve me qëllim të fshehjes së përfituesve të vërtetë.

- **Lidhje me vendet me rrezik të lartë** – Transaksionet që përfitojnë individë, kompani ose vende që janë subjekt i sanksioneve ndërkombëtare ose vendore.

b) Përveç indikatorëve të përmendur më sipër, në kufi mund të hasen edhe indikatorë të tjerë të riskut që lidhen me pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit. Këta indikatorë janë të bazuar në analiza të detajuara të profilin e udhëtarëve, mallrave, automjeteve dhe metodave të përdorura për të shmangur kontrollin doganor. Disa nga këto indikatorë janë:

- **Profilin e udhëtarëve**

- **Udhëtimet e shpeshta pa justifikim** – Udhëtimet e shpeshta në destinacione të njohura për veprimtari kriminale ose pa qëllim të qartë ekonomik ose personal.

- **Mungesa e informacionit dhe përgjigjet e paplota** – Udhëtarët që nuk janë në gjendje të shpjegojnë arsyen e saktë të udhëtimit, itinerarin apo kontaktet e tyre në vendet e destinacionit dhe detajet e veprimtarisë së tyre në vendin e origjinës.

- **Udhëtim nga persona me identitet të rremë** – Përdorimi i dokumenteve të identifikimit të dyshimta ose me identitete të ndryshme për të shmangur gjurmimin nga autoritetet.

- **Transporti i mallrave me rrezik të lartë**

- **Mallra me përmbajtje ose origjinë të dyshimtë** – Transporti i mallrave, të cilat nuk korrespondojnë me dokumentacionin përkatës ose që janë ndaluar për shkak të sanksioneve ndërkombëtare.

- **Transporti i sendeve të vogla me vlerë të madhe** – Stoli, gurë të çmuar, metale të rralla, që mund të përdoren për të maskuar transferimet ilegale të fondeve.

- **Veprimtari e dyshimtë e automjeteve**

- **Kalimi i shpeshtë i automjeteve të njëjta në kufi** – Automjete që kalojnë shpesh kufirin me

ngarkesa të ndryshme ose të papërcaktuara qartë, duke sugjeruar përfshirje në trafik të mallrave ose fondeve të paligjshme.

- **Mungesa e dokumenteve të duhura për automjetin ose shoferin** – Automjete që udhëtojnë me dokumente të falsifikuara ose të munguara, si dhe shoferë me histori të dyshimtë në lidhje me veprimtari të paligjshme.

- **Metodat e fshehjes së të ardhurave paligjshme**

- **Deklarime të rreme të aktivitetit ekonomik** – Subjekte që pretendojnë të përfshihen në tregti legjitime, por që nuk kanë veprimtari të vërtetë ose nuk janë të regjistruara ligjërisht.

- **Mungesa e dokumenteve justifikues për origjinën e fondeve** – Kur individë ose kompani nuk arrijnë të paraqesin dokumente të sakta që justifikojnë burimin e fondeve ose mallrave të tyre.

- **Përdorimi i “smurfing” për të shpërndarë sasi të vogla parash** – Ndarrja e shumave të mëdha të parave në shumë transaksione të vogla për të shmangur raportimin doganor.

- **Përdorimi i ndërmjetësve ose transportuesve të pavetëdijshëm** – Rekrutimi i personave të cilët transportojnë para ose mallra pa qenë të vetëdijshëm për qëllimin e paligjshëm të transaksionit.

- **Transportimi i mallrave me vlera të ndryshuara qëllimisht** – Shumat që nuk i përgjigjen vlerës reale të tregut.

- **Metodat komplekse të transferimit të parave**

- **Përdorimi i rrjeteve informale për transferimin e fondeve (p.sh. Havala)** – Përdorimi i sistemit të transferimit të parave që funksionon jashtë sistemit bankar formal dhe është i vështirë për tu gjurmuar.

- **Dërgesa parash në forma alternative** – Shuma të mëdha parash që transportohen në forma të tilla si çeqe, letra me vlerë ose kuponë elektronikë, të cilat janë më të vështira për t'u ndjekur nga autoritetet.



UDHËZIM

Nr. 25, datë 10.11.2025

PËR NJË SHITESË NË UDHËZIMIN NR. 6, DATË 4.3.2020, TË MINISTRIT TË ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË, “PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE PËR AFATET E APLIKIMIT, TË ZBATIMIT TË KRITEREVE DHE PROCEDURAVE, PËR PËRCAKTIMIN E MASËS DHE MËNYRËS SË FINANCIMIT, SI DHE NUMRIN E ANËTARËVE DHE KRITERET E PËRZGJEDHJES SË KANDIDATËVE PËR ANËTARË KOMISIONI PËR DHËNIEN E BURSIVE TË PARASHIKUARA NGA FONDI I EKSELENCËS PËR STUDENTËT E SHKËLQYER DHE NËPUNËSIT CIVILË”

Në mbështetje të nenit 102, të Kushtetutës, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, dhe të vendimit nr. 160, datë 19.2.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për mbështetjen financiare të studentëve të shkëlqyer dhe të nëpunësve civilë” (Fondi i Ekselencës), i ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Në udhëzimin nr. 6, datë 4.3.2020, të ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë “Për përcaktimin e rregullave për afatet e aplikimit, të zbatimit të kriterëve dhe procedurave, për përcaktimin e masës dhe mënyrës së financimit, si dhe numrin e anëtarëve dhe kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve për anëtarë komisioni për dhënie e bursave të parashikuara nga Fondi i Ekselencës për studentët e shkëlqyer dhe nëpunësit civilë”, bëhet shtesa, si më poshtë:

a) Pas pikës 1, të kreut VI, shtohet pika 1/1 me përmbajtje, si më poshtë:

“1/1. Përcaktimet e këtij udhëzimi zbatohen vetëm për studentët përfitues të mbështetjes financiare, që vijojnë studimet në vitet e ndërmjetme dhe kanë përfituar bursë nga Fondi i Ekselencës sipas përcaktimeve të vendimit nr. 160, datë 19.2.2020 të Këshillit të Ministrave, “Për mbështetjen financiare të studentëve të shkëlqyer dhe nëpunësve civilë (Fondi i Ekselencës)”, i ndryshuar.”.

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit, Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, Komisioni Përzgjedhës dhe Sekretariati Teknik i Programit.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT
Mirela Kumbaro Furxhi

URDHËR

Nr. 140, datë 7.11.2025

PËR SHTYRJEN E AFATIT TË APLIKIMIT TË STANDARDIT NDËRKOMBËTAR TË RAPORTIMIT FINANCIAR 17 (SNRF 17) “KONTRATAT E SIGURIMIT”

Në mbështetje të nenit 3, pika 4 dhe pika 5, të ligjit nr. 25/2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 505, datë 17.7.2019, “Për miratimin e rregullores së brendshme të organizimit dhe funksionimit të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit”,

URDHËROJ:

1. Shpalljen e shtyrjes së afatit të aplikimit të Standardit Ndërkombëtar të Raportimit Financiar (SNRF) 17 “Kontratat e Sigurimit”.

2. Aplikimi i SNRF 17 “Kontratat e Sigurimit”, ka datë efektive 1 janar 2028.

3. Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCIVE
Petrit Malaj

**URDHËR****Nr. 1161, datë 7.11.2025**

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE
ME PATOGJENITET TË LARTË TË
SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË
SHTETIN E SUEDISË**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe të tranzitimit nga zonat e përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

- a) shpendëve të gjallë shtëpiakë;
- b) zogjve 24-orësh;
- c) shpendëve dekorativë;
- ç) materialit biologjik të shpendëve;
- d) vezëve të shpendëve;
- dh) mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht;
- e) nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht.

2. Zonat e prekura me sëmundjen e influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve të shfaqur në shtetin e Suedisë, janë sipas tabelës së mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2	Ndarja administrative e nivelit 3
Tomelilla*	-	-
Ängelholm*	-	-

Shënim. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

3. Certifikata veterinare të garantojë origjinën e ngarkesës së ardhur.

4. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve informojnë të gjitha subjektet importuese të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht për hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

5. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

6. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit informon rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht që vijnë nga vendet e sipërcituara në pikën 2.

7. Urdhri nr. 1101, datë 30.10.2025, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Suedisë”, shfuqizohet.

8. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Drejtoria e Politikave Veterinare, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Andis Salla

URDHËR**Nr. 1162, datë 7.11.2025**

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE
ME PATOGJENITET TË LARTË TË
SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË
SHTETIN E GJERMANISË**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe të tranzitimit nga zonat e përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:



- a) shpendëve të gjallë shtëpiakë;
 b) zogjve 24-orësh;
 c) shpendëve dekorativë;
 ç) materialit biologjik të shpendëve;
 d) vezëve të shpendëve;
 dh) mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht;
 e) nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht.

2. Zonat e prekura me sëmundjen e influencës aviare me patogenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Gjermanisë, janë sipas tabelës së mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2	Ndarja administrative e nivelit 3*
Brandenburg	Märkisch-Oderland	Neuhardenberg*
Bayern	Dingolfing-Landau	Simbach*
Schleswig-Holstein	Steinburg	Schenefeld*
Mecklenburg-Vorpommern	Rostock	Tessin*
Nordrhein-Westfalen	Paderborn	Delbrück*
Thüringen	Greiz	Zeulenroda-Triebes*
Schleswig-Holstein	Plön	Lütjenburg*
Niedersachsen	Cloppenburg	Garrel*
Niedersachsen	Diepholz	Stuhr*
Brandenburg	Potsdam-Mittelmark	Beetzsee*
Mecklenburg-Vorpommern	Mecklenburgische Seenplatte	Röbel-Müritz*
Mecklenburg-Vorpommern	Vorpommern-Greifswald	Torgelow-Ferdinandshof*
Mecklenburg-Vorpommern	Vorpommern-Rügen	Bergen auf Rügen*
Brandenburg	Oberhavel	Kremmen*
Baden-Württemberg	Alb-Donau-Kreis	Langenau*
Niedersachsen	Cloppenburg	Bösel*
Nordrhein-Westfalen	Kleve	Rees*
Niedersachsen	Vechta	Vechta*
Brandenburg	Märkisch-Oderland	Barnim-Oderbruch*
Brandenburg	Prignitz	Plattenburg*
Niedersachsen	Diepholz	Barnstorf*
Schleswig-Holstein	Nordfriesland	Föhr-Amrum*
Schleswig-Holstein	Nordfriesland	Sylt*
Niedersachsen	Emsland	Geeste*
Niedersachsen	Stade	Fredenbeck*
Niedersachsen	Harburg	Tostedt*

Niedersachsen	Oldenburg	Ganderkesee*
Mecklenburg-Vorpommern	Vorpommern-Greifswald	Peenetal/Loitz*
Brandenburg	Märkisch-Oderland	Letschin*
Niedersachsen	Cloppenburg	Friesoythe*
Brandenburg	Uckermark	Lychen*
Nordrhein-Westfalen	Wesel	Kamp-Lintfort*
Niedersachsen	Rotenburg (Wümme)	Selsingen*
Niedersachsen	Vechta	Goldenstedt*
Thüringen	Nordhausen	Ellrich*
Sachsen-Anhalt	Mansfeld-Südharz	Goldene Aue*
Niedersachsen	Emsland	Lengerich*
Niedersachsen	Rotenburg (Wümme)	Bremervörde*
Niedersachsen	Stade	Oldendorf-Himmelpforten*
Niedersachsen	Oldenburg	Harpstedt*
Niedersachsen	Diepholz	Altes Amt Lemförde*
Niedersachsen	Diepholz	Rehden*

Shënim. Simboli (*) nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.

3. Certifikata veterinare të garantojë origjinën e ngarkesës së ardhur.

4. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve informojnë të gjitha subjektet importuese të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht për hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

5. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

6. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit informon rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht, që vijnë nga vendet e sipërcituara në pikën 2.

7. Urdhri nr. 1141, datë 6.11.2025, "Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me



patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Gjermanisë”, shfuqizohet.

8. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Drejtoria e Politikave Veterinare, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Andis Salla

VENDIM
Nr. 51, datë 25.9.2025

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë,
e përbërë nga:

Holta Zaçaj,	kryetare;
Marsida Xhaferllari,	anëtare;
Fiona Papajorgji,	anëtare;
Sonila Bejtja,	anëtare;
Sandër Beci,	anëtar;
Ilir Toska,	anëtar;
Marjana Semini,	anëtare;
Genti Ibrahim	anëtar,

me sekretare Anjeza Puka, në datën 25.9.2025 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 16 (B) 2024, që u përket:

KËRKUES: Bardhyl Ibra

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Ministria e Drejtësisë, përfaqësuar nga Xhelal Kasaj, Erjon Ndreca dhe Albjona Toçi, me autorizim.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, përfaqësuar nga Ilir Rusi.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, pranë Ministrisë së Brendshme, në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2024-3271, datë 23.7.2024, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Zhvillimi i gjykimit nga një gjykatë jokompetente, për shkak të konflikteve të herëpashershme me

gjyqtaren A.A. të Gjykatës së Lartë, duke qenë relatore e çështjes.

Konstatimi i cenimit të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, si rezultat i mosgjykimit të çështjes brenda një afati të arsyeshëm, të parashikuar në pikën 2 të nenit 399/7 të Kodit të Procedurës Civile, të kërkesës nr. regjistrimi 31138-04501-86-2017, datë 11.9.2017, pranë sekretarisë së Gjykatës Administrative të Apelit dhe përshpejtimin e shqyrtimit të çështjes, pasi ende nuk është gjykuar.

BAZA LIGJORE: Nenet 15, 16, 18, 42, pika 2, 43 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 6, pika 1 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*); nenet 399/1-399/12, 474 dhe 475 të KPC-së.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Genti Ibrahim, mori në shqyrtim parashtrimet me shkrim të kërkesit Bardhyl Ibra (*kërkuesi*), që ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjekteve të interesuara, Ministrisë së Drejtësisë dhe Këshillit të Lartë Gjyqësor (*KLJ*), të cilat kanë kërkuar rrëzimin e kërkesës, konstatoi mungesën e prapësimeve me shkrim të subjektit tjetër të interesuar, Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi ka paraqitur në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë një ankesë kundër ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë (sot Këshilli i Lartë Gjyqësor), ministrit të Drejtësisë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile, me objekt dhënien e informacionit të kërkuar prej tij në lidhje me identitetin e një gjyqtari.

2. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 2469, datë 5.6.2017, bazuar në nenin 39 të ligjit nr. 49/2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar (*ligji nr. 49/2012*) dhe vendimin unifikues nr. 3, datë 29.3.2012 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë,



ka vendosur mospranimin e ankimit të paraqitur nga kërkuesi, me arsyetimin se kërkesa nuk plotëson kushtet formale të paraqitjes së saj. Kundër këtij vendimi ka bërë ankim të veçantë kërkuesi dhe çështja është regjistruar në Gjykatën Administrative të Apelit në datën 11.9.2017, me numër 16041(31138-04501-86-2017) akti. Në kushtet kur çështja nuk po shqyrtohej nga gjykata e apelit, në datën 27.6.2024, bazuar në nenet 399/4, 399/5 dhe 399/6, pika 1, shkronja “b”, të KPC-së, kërkuesi ka depozituar në Gjykatën e Lartë kërkesë për konstatimin e cenimit të së drejtës për proces të rregullt ligjor si rezultat i mosgjykimit të çështjes brenda afatit të arsyeshëm dhe përshejtimin e gjykimit nga Gjykata Administrative e Apelit.

3. Në datën 3.7.2024 gjyqtarja raportore e çështjes i është drejtuar kërkuesit me vendim për plotësimin e të metave të kërkesës duke konstatuar si të metë parashikimin e nenit 56/a shkronja “d”, të ligjit nr. 49/2012 dhe të nenit 474 KPC-së, konkretisht, nënshkrimin e avokatit, duke vendosur t’i caktojë atij një afat pesë ditë për plotësimin e të metave, siç përcaktohet në pjesën arsyetuese të këtij vendimi.

4. Në datën 9.7.2024 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Lartë me aktin “plotësim të metash”, ku përveç pretendimeve në lidhje me vendimin e plotësimit të të metave ka kërkuar edhe zëvendësimin e trupit gjykues, pasi ky trup ka rrëzuar kërkesa të mëparshme të paraqitura prej tij dhe, po ashtu, ky trup ka për gjykim edhe kërkesa të tjera të kërkuesit për të cilat nuk ka ende një vendimmarrje prej tij.

5. Me vendimin e datës 22.7.2024, gjyqtari i vetëm i Kolegjit Penal ka rrëzuar kërkesën e kërkuesit për përjashtimin e trupit gjykues, me arsyetimin se kërkesa e tij nuk është shoqëruar me asnjë dokument provues në drejtim të shkakut të pretenduar. Pavarësisht faktit se ky trup gjykues ka gjykuar ose ka në gjykim edhe kërkesa të tjera të kërkuesit, ato nuk lidhen me çështjen objekt gjykimi, si dhe nuk rezultojnë që të jenë kërkesa për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm, gjykim në të cilin trupi gjykues nuk shqyrton themelin e çështjes, por vlerëson respektimin e afatit të arsyeshëm nga gjykata që ka çështjen në gjykim.

6. Në vijim, Gjykata e Lartë i ka kërkuar informacion gjykatës së apelit lidhur me kërkesën për shkeljen e afatit të arsyeshëm nga gjyqtarja raportore e çështjes (gjyqtarja E.SH.), e cila në mendimin me shkrim të datës 24.5.2024 ka

parashtruar se është objektivisht i pamundur shqyrtimi në kohë i kësaj çështjeje dhe kjo vonesë nuk mund të përbëjë shkak për shkelje të afatit të arsyeshëm nga gjykata e apelit. Po sipas gjyqtarës raportore, për shqyrtimin e çështjeve ajo zbaton rendin kronologjik, duke iu referuar datës së regjistrimit, ku aktualisht po gjykon çështjet e regjistruara në vitin 2017 dhe nuk rezultojnë se nga kërkuesi të jetë kërkuar përshejtimi i gjykimit për shkaqe të arsyeshme.

7. Me vendimin nr. 00-2024-3271, datë 23.7.2024, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, ka vendosur rrëzimin e kërkesës së kërkuesit për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm të gjykimit të çështjes së tij nga Gjykata Administrative e Apelit. Sipas atij kolegji, mosveprimi i Gjykatës Administrative të Apelit nuk ka ndodhur për shkaqe subjektive që lidhen me vlerësime dhe qëndrime abuzive të gjyqtarës raportore të çështjes, e cila ka marrë të gjitha masat e nevojshme organizative, duke përcaktuar kritere transparente dhe objektive për marrjen në gjykim të çështjeve që i janë ngarkuar në cilësinë e gjyqtarit raportor, sipas radhës së vjetërsisë. Po sipas saj, për shkak të problematikës së përgjithshme të shkaktuar nga reforma në drejtësi, Gjykata Administrative e Apelit ndodhet në pamundësi objektive për marrjen e masave për shqyrtimin e kësaj çështjeje me përshejtim.

8. Në datën 20.12.2024 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij. Kolegji i Gjykatës në datën 12.3.2025, bazuar në nenin 21, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II. Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

9. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmblodhur, ka pretenduar se i është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të:

9.1. *Së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm*, për shkak se Gjykata e Lartë nuk ka marrë parasysh faktin se nga momenti i regjistrimit të çështjes në Gjykatën Administrative të Apelit deri në paraqitjen e kërkesës për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm kanë kaluar rreth shtatë vjet, dhe megjithëse çështja nuk paraqitet komplekse, ajo nuk është shqyrtuar ende. Edhe pse mosgjykimi i çështjes ka ardhur si pasojë e mosplotësimit të



numrit të gjyqtarëve në Gjykatën Administrative të Apelit nga organet përkatëse, justifikimi i Gjykatës së Lartë se vonesat në gjykim janë rrjedhojë e numrit të lartë të çështjeve është vlerësuar i pabazuar nga jurisprudenca kushtetuese. Ai nuk është bërë shkak për zvarritjen e procesit dhe mosha e tij është 73-vjeçare.

9.2. *Parimit të barazisë para ligjit*, pasi Gjykata e Lartë nuk ndjek të njëjtën praktikë për kërkesat për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e gjykimit të çështjes, ku njëri trup gjykues i Kolegjit Administrativ të saj i ka dhënë të drejtë kërkesit, por pavarësisht kësaj Gjykata e Lartë nuk e ka kaluar çështjen për njësim të praktikës gjyqësore.

9.3. *Së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme*, pasi në kolegjin që ka shqyrtuar çështjen e tij në Gjykatën e Lartë ka marrë pjesë edhe gjyqtarja A.A., me të cilën ai ka mosmarrëveshje në kuptim të nenit 72 të KPC-së.

10. **Subjekti i interesuar, Ministria e Drejtësisë**, në mënyrë të përmbledhur, ka parashtruar se kërkesi nuk ka paraqitur argumente kushtetuese në mbështetje të pretendimeve të ngritura. Kërkesi nuk ka provuar se ka interes të vazhdueshëm për gjykimin sa më të shpejtë të çështjes së themelit nga Gjykata Administrative e Apelit, pasi nuk ka shfrytëzuar mjetet procedurale që garanton legjislacioni në fuqi për përshpejtimin e çështjes. Sjellja e kërkesit në këtë rast vërteton se të drejtat e tij nuk kanë qenë të rrezikuara në nivele të konsiderueshme nga mosgjykimi i çështjes brenda afateve ligjore. Ai nuk ka paraqitur argumente konkrete që faktojnë rrezikun që ka sjellë ose që eventualisht mund të sjellë tejzgjatja e procedurave gjyqësore nga Gjykata Administrative e Apelit dhe Gjykata e Lartë. Për më tepër, nisur nga natyra e çështjes, ajo nuk është e tillë që të ketë përparësi në radhën e gjykimit të çështjeve nga gjyqtarja relatore, për sa kohë që në këtë proces gjyqësor që kërkesi pretendon gjykimin brenda afatit të arsyeshëm atij kërkesa i është kthyer vetëm për të meta në aspektin formal, aspekte që ia bëjnë të pamundur gjykatës gjykimin në themel të pretendimeve të kërkesit.

11. **Subjekti i interesuar, KLGJ-ja**, në mënyrë të përmbledhur, ka parashtruar se kërkesi nuk ka shfrytëzuar mjetin ligjor të parashikuar nga dispozitat procedurale për të kërkuar përshpejtimin e gjykimit të çështjes së tij nga Gjykata Administrative e Apelit. Në rastin e kërkesit nuk

duket që tejzgjatja e procedurave të paraqesë një shkallë rreziku të konsiderueshme për interesin e kërkesit. Mosveprimi i gjykatës në rastin e kërkesit nuk ka ndodhur për shkaqe subjektive që lidhen me vlerësime dhe qëndrime abuzive të gjyqtarit. Në asnjë rast cilësia e procesit të rregullt ligjor dhe e vendimmarrjes së gjykatës nuk duhet të sakrifikohet për sasinë e afatit të arsyeshëm ose dhe ekonominë gjyqësore në tërësi. Për sa i takon pretendimit të kërkesit për cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme, pavarësisht faktit se gjyqtarja A.A ka qenë pjesë e trupit gjykues që ka gjykuar ose ka në gjykim kërkesa të tjera të kërkesit, ka rezultuar e provuar edhe nga Gjykata e Lartë se objekti i kërkesave të tij konsistonte në konstatimin e afatit të arsyeshëm, ku trupi gjykues në këto raste nuk shqyrton themelin e çështjes, por vlerëson respektimin e afatit të arsyeshëm nga gjykata që ka çështjen në shqyrtim. Në asnjë moment nuk është provuar nga kërkesi se gjyqtarja ka shfaqur mendime lidhur me çështjen konkrete në mënyrë që të krijohet perceptimi për njëanshmëri.

12. **Subjekti tjetër i interesuar, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile**, nuk ka paraqitur prapësime me shkrim, edhe pse është njoftuar rregullisht.

III. Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkesit

13. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

14. Në lidhje me legjitimitimin *ratione personae*, sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, individ i është subjekt i cili mund të paraqesë ankim kushtetues individual vetëm për çështje që lidhen me interesat e



tij të drejtpërdrejta, duke provuar se është cenuar në të drejtat e tij kushtetuese, pra se është viktimë e një shkeljeje dhe se pasojat nga akti i kundërshtuar janë të drejtpërdrejta dhe reale për të. Kjo do të thotë se kërkuesi duhet të provojë legjitimitimin e tij si në aspektin procedural, ashtu edhe në atë substancial (*shih vendimet nr. 65, datë 30.11.2023; nr. 44, datë 26.9.2023, të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Në rastin konkret, Gjykata vëren se në themelin e mosmarrëveshjes gjyqësore është kërkesa për dhënie informacioni të kërkuar prej kërkuetit në lidhje me identitetin e një gjyqtari, për të cilën Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur mospranimin si të pabazuar, me arsyetimin se kërkesa nuk plotëson kushtet formale të paraqitjes së saj. Sipas asaj gjykate, duke qenë se kërkohet detyrimi i palës së paditur që të kryejë një veprim konkret, atëherë e drejta subjektive e ankuesit nuk mund të realizohet nëpërmjet kësaj ankese, por nëpërmjet kërkesëpadisë, pasi vetëm nëpërmjet këtij mjeti procedural gjykata mund të marrë një vendim detyrues. Kundër këtij vendimi ka ushtruar ankim në gjykatën e apelit kërkueti, i cili është regjistruar në datën 11.9.2017. Duke qenë se çështja ende nuk ishte gjykuar nga gjykata e apelit, kërkueti në datën 27.6.2024 i është drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesë për konstatimin e cenimit të afatit të arsyeshëm, për të cilën Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin e datës 23.7.2024, ka vendosur rrëzimin, duke vlerësuar se standardi i gjykimit brenda një afati të arsyeshëm nuk cenohet kur gjykata është në pamundësi objektive, që nuk varen nga vullneti i saj, për gjykimin e çështjes brenda një afati të arsyeshëm. Kundër këtij vendimi kërkueti i është drejtuar Gjykatës me ankim individual.

16. Gjykata vëren se për sa i përket themelit të çështjes së kërkuetit, pas shqyrtimit të ankimit të tij, Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 2238(86-2024-2481), datë 19.12.2024 ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 2469, datë 5.6.2017, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, duke marrë kështu kërkueti përgjigje për thelbin e pretendimeve të tij nga gjykata e pretenduar se ka qenë në vonesë. Në rastin e kërkuetit rezulton se ai i ka përdorur mjetet juridike në dispozicion, sipas neneve 399/1 e vijuese të KPC-së, me qëllimin për të siguruar përshejtimin e gjykimit të ankimit të tij nga Gjykata Administrative e Apelit dhe për të pasur një vendim të arsyetuar për shkaqet e ankimit të tij.

Në këto kushte, për sa kohë që shqyrtimi i çështjes së kërkuetit nga ajo gjykatë ka përfunduar, çka do të thotë se është realizuar qëllimi që ka synuar të arrijë kërkueti përmes këtyre mjeteve juridike, Gjykata çmon se kërkueti nuk ka më interes në këtë gjykim kushtetues. Për rrjedhojë, në këto kushte, kriteri i interesit të kërkuetit për të vënë në lëvizje gjykimin kushtetues nuk konsiderohet i plotësuar, pasi për sa kohë që ai ka marrë përgjigje përfundimtare nga gjykata e apelit, konsiderohet se është rivendosur e drejta e pretenduar që synonte të mbronte nëpërmjet këtij procesi.

17. Për sa më sipër, në situatën që çështja e kërkuetit në gjykatën e apelit ka përfunduar tashmë, Gjykata vlerëson se kërkueti nuk legjitimohet *ratione personae* në ankimin kushtetues individual, pasi nuk ka arritur të provojë interesin e tij të drejtpërdrejtë dhe individual për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues.

18. Në përfundim, Gjykata çmon se kërkesa e kërkuetit duhet të rrëzohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, si dhe neneve 71/a dhe 72, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 25.9.2025.

Shpallur më 12.11.2025.

Kryetare: Holta Zaçaj

Anëtar: Fiona Papajorgji, Marsida Xhaferllari, Ilir Toska, Sandër Beci, Sonila Bejtja, Genti Ibrahimi, Marjana Semini



VENDIM
Nr. 56, datë 10.10.2025

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë,
e përbërë nga:

Holta Zaçaj	kryetare;
Marsida Xhaferllari	anëtare;
Fiona Papajorgji	anëtare;
Sonila Bejtja	anëtare;
Sandër Beci	anëtar;
Genti Ibrahim	anëtar;
Marjana Semini	anëtare;
Ilir Toska	anëtar,

me sekretare Anjeza Puka, në datën 9.10.2025
mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të
dokumenteve çështjen nr. 2 (Sh) 2025 të Regjistrat
Themeltar, që u përket:

KËRKUES: Shoqëria “Siontis” s.a.

SHOQËRIA “Design and Construction Siontis”
s.a.

Christos Siontis (Kristos Siontis), të përfaqësuar
nga avokat Avni Shehu, me prokurë.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

Shoqëria Tregtare “Gjallica” sh.p.k., në
administrim, në mungesë.

Zyra Përmbartimore Elbasan, në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 24 (86-
2017-1981), datë 9.5.2017, të Gjykatës
Administrative të Apelit; nr. 00-2024-2777, datë
27.6.2024, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së
Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e
Republikës së Shqipërisë.

Dërgimi i çështjes për rishqyrtim në Gjykatën
Administrative të Apelit.

BAZA LIGJORE: Nenet 11, pika 2, 15, 41, 42,
121, 122, 131, pika 1, shkronja “P”, dhe 134 të
Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*);
neni 6, pika 1, i Konventës Evropiane për të Drejtat
e Njeriut; nenet 27, pikat 1 dhe 2, 71, pika 1, 71/a
dhe 71/b të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për
organizimin dhe funksionimin e Gjykatës
Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të
ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*); ligji nr. 7760, datë
14.10.1993, “Për ratifikimin e Konventës ndërmjet
Republikës së Shqipërisë dhe Greqisë për ndihmën
gjyqësore në çështjet civile dhe penale”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Ilir Toska, mori në
shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuësve, të
cilët kanë kërkuar pranimin e kërkesës, konstatoi
mungesën e parashtrimeve me shkrim të subjekteve
të interesuara, shoqërisë tregtare “Gjallica” sh.p.k.
(*shoqëria “Gjallica”*) në administrim dhe Zyrës
Përmbartimore Elbasan, si dhe diskutoi çështjen në
tërësi,

VËREN:

I
Rrethanat e çështjes

1. Shoqëritë “Siontis” s.a. (*kërkuesi i parë*) dhe
“Design and Construction Siontis” s.a. (*kërkuesi i*
dytë) janë persona juridikë të së drejtës greke, me seli
në qytetin e Janinës dhe me administrator kërkuësin
Christos Siontis (Kristos Siontis) (*kërkuesi i tretë*).
Midis kërkuësit të dytë, në cilësinë e sipërmarrësit
dhe shoqërisë “Gjallica”, në cilësinë e porositësit, në
datat 4.4.1996 dhe 10.8.1996 janë nënshkruar dy
kontrata, respektivisht për ndërtimin e objektit
“Business Center Albania” në qytetin e Vlorës, me
kosto punimesh në vlerën 3,300,000 dollarë
amerikanë (USD) dhe për ndërtimin e fabrikës së
tullave në Vlorë, me kosto punimesh në vlerën
1,300,000 USD. Për këtë qëllim shoqëria “Gjallica”
ka bërë disa pagesa në favor të sipërmarrësit.

2. Në bazë të ligjeve nr. 8188, datë 23.1.1997,
“Për ndalimin e skemave piramidale mashtruese të
huamarrjes” dhe nr. 8215, datë 9.5.1997 “Për
kontrollin financiar të personave juridikë jobankarë
që kanë marrë hua nga publiku i gjerë”, i ndryshuar
(*ligji nr. 8215/1997*) veprimtaria e shoqërisë
“Gjallica” është ndërprerë dhe ajo është vendosur
në administrim. Me VKM-në nr. 44, datë 21.1.1999,
të botuar në Fletoren Zyrtare, kërkuësi i parë është
deklaruar, mes të tjerave, si person juridik i lidhur me
shoqërinë huamarrëse “Gjallica”. Pas shqyrtimit të
dokumentacionit të shoqërisë në administrim,
bazuar në ligjin nr. 8471, datë 8.4.1999, “Për
nxjerrjen e detyrimeve debitorëve dhe rikthimin e
vlerave pasurore në llogaritë e personave juridikë,
jobankarë që kanë marrë hua nga publiku i gjerë”
(*ligji nr. 8471/1999*), administratorët e përbashkët të
shoqërisë “Gjallica” në administrim kanë deklaruar
debitorë: i. kërkuësit e parë dhe të tretë, për shumën



295,920,000 lekë, me vendimin nr. 15, datë 11.8.1999 (*vendimi i administratorëve nr. 15/1999*), për të cilin, duke qenë titull ekzekutiv sipas ligjit të veçantë, është lëshuar urdhri i ekzekutimit me vendimin nr. 835 akti, datë 18.4.2008, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë (*urdhri gjyqësor i ekzekutimit nr. 835/2008*); ii. kërkesit e dytë dhe të tretë, për shumën 1,700,000 USD, me vendimin nr. 2, datë 7.9.2009 (*vendimi i administratorëve nr. 2/2009*), për të cilin është lëshuar urdhri i ekzekutimit me vendimin nr. 911 akti, datë 25.3.2010, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë (*urdhri gjyqësor i ekzekutimit nr. 911/2010*), vendim që, gjithashtu, konsiderohej titull ekzekutiv sipas ligjit të veçantë.

3. Në datën 3.5.2010 shoqëria “Gjallica” në administrim i është drejtuar Zyrës Përmbartimore Elbasan, së cilës, më herët, në datën 29.4.2010, i është drejtuar edhe kërkesi i tretë për vënien në ekzekutim të vendimit nr. 509, datë 19.3.2010, të Gjykatës së Apelit Tiranë (*vendimi gjyqësor nr. 509/2010*), me të cilin është vendosur detyrimi i një shoqërie të tretë për t'i kthyer këtij kërkuesi disa mjete dhe makineri.

4. Gjatë procedurës së ekzekutimit të detyrueshëm të kërkesës së shoqërisë “Gjallica” në administrim, Zyra Përmbartimore Elbasan, me vendimin e datës 2.6.2010, ka vendosur masën e sekuestros për disa sende të luajtshme të kërkuetit të tretë (mjete dhe makineri), për të cilat ai ishte në procedurë ekzekutimi si kreditor, sipas vendimit gjyqësor nr. 509/2010. Duke mos qenë dakord me këtë veprim përmbartimor, kërkuesi i tretë i është drejtuar gjykatës së apelit për kundërshtimin e vendimit të sekuestros dhe anulimin e tij, pezullimin e titullit ekzekutiv, vendimit të administratorëve nr. 2/2009, si dhe urdhërimit të Zyrës Përmbartimore Elbasan të ekzekutojë vendimin gjyqësor nr. 509/2010. Në përfundim të këtij gjykimi, Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. 28, datë 20.9.2010, ka vendosur rrëzimin e padisë.

5. Nga ana tjetër, në datën 17.6.2010, kërkuesi i dytë i është drejtuar gjykatës së apelit me padi, me objekt: i. kundërshtimin e veprimit përmbartimor, vendimit të sekuestros dhe anulimin e tij; ii. kundërshtimin e titullit ekzekutiv, vendimit të administratorëve nr. 2/2009 dhe anulimin e tij; iii. pezullimin e ekzekutimit të vendimit të sekuestros dhe të titullit ekzekutiv; iv. rivendosjen në afat të padisë. Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. 27, datë 15.9.2010, ka vendosur pushimin e gjykimit për

shkak të mosparaqitjes të kërkuetit të dytë në seancë gjyqësore, pa shkaqe të përligjura.

6. Po ashtu, në datën 21.6.2010, edhe kërkuesi i parë i është drejtuar gjykatës së apelit me padi, me objekt: i. kundërshtimin e veprimit përmbartimor, vendimit të sekuestros dhe anulimin e tij; ii. kundërshtimin e titullit ekzekutiv, vendimit të administratorëve nr. 15/1999 dhe anulimin e tij; iii. pezullimin e ekzekutimit të vendimit të sekuestros dhe të titullit ekzekutiv; iv. rivendosjen në afat të padisë. Gjatë gjykimit të kësaj çështjeje gjykata e apelit ka vendosur bashkimin e saj me çështjen e vënë në lëvizje në datën 4.11.2010 nga kërkuesi i dytë me të njëjtin objekt padie (*shih paragrafin 5 të vendimit*). Po ashtu, gjykata e apelit ka vendosur edhe pranimin e kërkesës së datës 9.2.2011 për ndërhyrje kryesore të kërkuetit të tretë, duke shqyrtuar edhe padinë e paraqitur prej këtij të fundit. Në përfundim të gjykimit, Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. 15, datë 12.4.2011, ka vendosur rrëzimin e padisë, vendim që është prishur me vendimin nr. 00-2015-1251 (379), datë 9.6.2015, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë dhe çështja është dërguar për rishqyrtim në Gjykatën Administrative të Apelit.

7. Gjatë rigjykimit të çështjes, Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin e ndërmjetëm të datës 8.6.2016, ka vendosur ndarjen dhe gjykimin veçmas të kërtimeve, atij për rivendosjen në afat të padisë nga kërkimet për themelin e mosmarrëveshjes, atyre për: a) kundërshtimin e veprimeve të përmbartuesit gjyqësor për vendosjen e masës së sekuestros mbi sendet e luajtshme dhe anulimin e tij; b) kundërshtimin e titujve ekzekutivë, vendimeve të administratorëve nr. 15/1999 dhe nr. 2/2009 dhe anulimin e tyre; c) pezullimin e ekzekutimit të vendimit të sekuestros dhe të titujve ekzekutivë.

i. Procesi gjyqësor për kërkimin e rivendosjes në afat të padisë

8. Për kërkimin e rivendosjes në afat të padisë, Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 49, datë 15.11.2016 (*vendimi nr. 49/2016*), ka vendosur rrëzimin e tij, kurse Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, mbi rekursin e kërkuetve, me vendimin nr. 00-2024-17(4), datë 11.1.2024, ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe pushimin e gjykimit të çështjes.

9. Në datën 10.5.2024 kërkuetit kanë paraqitur ankim kushtetues individual për kundërshtimin e



këtyre vendimeve, për të cilin Kolegji i Gjykatës, me vendimin nr. 172, datë 19.7.2024, ka vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare, për shkak të mosplotësimit të kriterit të shterimit të mjeteve juridike në dispozicion. Sipas Kolegjit të Gjykatës, pretendimet e kërkuessve kanë të bëjnë me themelin e mosmarrëveshjes, e cila është shqyrtuar në një proces të ndarë nga procesi gjyqësor i kundërshtuar, ndaj duke mbajtur parasysh se në përfundim të këtij të fundit është vendosur pushimi i gjykimit, kërkuessit kanë ende mundësitë dhe mjetet juridike për mbrojtjen e të drejtave të pretenduara të cenuara, duke mos përjashtuar edhe mbrojtjen kushtetuese në këtë Gjykatë në rast të një vendimi gjyqësor përfundimtar të pafavorshëm për ta.

ii. Procesi gjyqësor për kërkimet e padisë për themelin e mosmarrëveshjes

10. Pas ndarjes së kërtimeve të padisë dhe gjykimin veçmas të tyre, për sa u përket atyre për themelin e mosmarrëveshjes në lidhje me kundërshtimin dhe anulimin e veprimit përmbartimor, vendimit të sekuestros dhe kundërshtimin dhe anulimin e titujve ekzekutivë, vendimeve të administratorëve nr. 15/1999 dhe nr. 2/2009, si dhe për pezullimin e tyre, Gjykata Administrative e Apelit, fillimisht, me vendimin e ndërmjetëm të datës 17.10.2016, bazuar në nenin 297, pika 1, shkronjat “a” dhe “b”, të Kodit të Procedurës Civile (KPC), ka vendosur pezullimin e gjykimit deri në përfundim të procesit gjyqësor në lidhje me kërkimin për rivendosjen në afat të padisë, duke vlerësuar se kërkimet e padisë në këtë gjykim nuk mund të shqyrtohen në themel pa u përcaktuar gjyqësisht nëse ishte parashkuar apo jo padia për anulimin e vendimeve të administratorëve të shoqërisë “Gjallica” në administrim dhe për kundërshtimin e veprimeve të përmbartuesit gjyqësor, si dhe pezullimin e tyre.

11. Pas përfundimit në gjykatën e apelit të procesit gjyqësor për rivendosjen në afat të padisë, Gjykata Administrative e Apelit ka vijuar gjykimin e kërtimeve për themelin e mosmarrëveshjes dhe në përfundim, me vendimin nr. 24 (86-2017-1981), datë 9.5.2017, ka vendosur rrëzimin e padisë.

12. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-2777, datë 27.6.2024, në dhomën e këshillimit, ka vendosur mospranimin e rekursit, me arsyetimin se nuk përmban shkaqe nga ato të parashkuara në nenin 58 të ligjit nr. 49/2012,

“Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar (ligji nr. 49/2012), që të jenë të afta dhe të passjellin cenim të vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit.

13. Në datën 9.1.2025 kërkuessit kanë paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatën Kushtetuese (Gjykata), sipas objektit të tij, i cili, pasi është plotësuar sipas kërkesave të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 13.1.2025. Kolegji i Gjykatës, me vendimin e datës 25.3.2025, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

14. Kërkuessit, në mënyrë të përmbledhur, kanë pretenduar se u është cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor, e parashkuar në nenin 42 të Kushtetutës, në drejtim të:

14.1. *Së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj*, pasi gjykata e apelit nuk ka marrë parasysh se gjykatat shqiptare nuk janë kompetente për sa kohë që palët kanë përcaktuar si kompetente Gjykatën Ndërkombëtare të Parisit për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve mes tyre në lidhje me kontratat e sipërmarrjes të datave 4.4.1996 dhe 10.8.1996. Shoqëria “Gjallica”, pavarësisht se është shoqëri në administrim, si palë e kontratës nuk mund të përcaktojë në mënyrë të njëanshme me fuqinë e një titulli ekzekutiv, detyrimin e kërkuessve si palë kontraktuese. Ky kusht kontraktor i përcaktuar në kontratat e lidhura mes palëve është detyrues, në kuptimin që asnjë gjykatë tjetër, e cilitdo vendi, nuk mund të merret me zgjidhjen e mosmarrëveshjeve që mund të lindnin nga moszbatimi i kontratave. Shkelja me qëllim e dispozitave që rregullojnë juridiksionin e gjykatave nga shoqëria “Gjallica” në administrim dhe administratorët e saj e bën të pavlefshme të gjithë procedurën e ndjekur.

14.2. *Parimit të paanshmërisë në gjykim*, pasi gjyqtarët A.A. dhe A.V. kanë marrë pjesë si në trupin gjykuess të Gjykatës së Lartë që ka shqyrtuar kërkesën për rivendosjen në afat të padisë, ashtu edhe në atë që ka gjykuar edhe pjesën tjetër të padisë për kundërshtimin e veprimit përmbartimor të sekuestrimit dhe për pavlefshmërinë e titujve ekzekutivë, vendimeve të administratorëve të shoqërisë “Gjallica” në administrim. Edhe pse është



kërkuar përjashtimi ose heqja dorë e këtyre gjyqtarëve, kjo kërkesë është rrëzuar nga Gjykata e Lartë.

14.3. *Së drejtës së aksesit dhe parimit të barazisë së armëve e kontradiktoritetit në gjykim*, pasi Gjykata Administrative e Apelit, si gjykatë e shkallës së parë, nuk ka marrë në shqyrtim provat e paraqitura nga kërkuesit, përfshirë edhe provat e reja shkresore që vërtetonin mosekzistencën e detyrimit, si dhe nuk ka zhvilluar një hetim shterues. Përfundimi i asaj gjykate për rrëzimin e padisë si të parashkruar është i pabazuar në prova dhe ligj, pasi padia për pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv është një padi që, sipas ligjit të kohës, nuk parashkruhet dhe mund të ngrihet në çdo kohë, ndaj gjykata e apelit ishte e detyruar ta shqyrtonte atë në themel, duke marrë të gjitha provat që vërtetonin se detyrimi nuk ekzistonte ose ekzistonte në një masë më të vogël. Kërkuesi i parë ka përmbushur detyrimet kontraktuale duke përgatitur studimet dhe projektet, të cilat i janë dorëzuar shoqërisë “Gjallica”, sikundër ka përgatitur edhe skeletin metalik të fabrikës, i cili gjendej në Janinë, përveçse ka përfunduar edhe punimet parapërgatitore ndërtimore në rajonin e zgjedhur për ngritjen e fabrikës. Vlera e këtyre punimeve nuk u llogarit asnjëherë, përveçse edhe mosdorëzimi i tyre ka ndodhur nga pafuqia e marrjes së tyre në dorëzim nga vetë shoqëria “Gjallica”. Për më tepër, pas datës 31.12.1997 të përfundimit të afatit të kontratave të sipërmarrjes, çdo pretendim i shoqërisë “Gjallica” për përmbushjen e tyre u bë i vonuar, duke sjellë parashkrimin e së drejtës për kërkimin e përmbushjes së detyrimeve, qoftë sipas ligjit grek, që parashikon një afat 5-vjeçar, ashtu edhe sipas ligjit shqiptar, që parashikon një afat 10-vjeçar. Pretendimet e asaj shoqërie në çdo rast u ngritën në vitin 2010. Ajo shoqëri nuk ka të drejtë të kërkojë pagesën e cilësdo shumë nga kërkuesi i tretë, i cili nuk ka qenë palë kontraktuese. Gjykatat e juridiksionit të zakonshëm po ashtu nuk kanë mbajtur parasysh as faktin se çështja është gjykuar nga gjykatat greke, vendimet e të cilave nuk janë marrë parasysh dhe as nuk përmenden në arsyetimin e vendimeve gjyqësore.

14.4. *Së drejtës së ankimit*, pasi Gjykata e Lartë, për sa kohë që gjykata e apelit ka gjykuar si shkallë e parë, duhet ta gjykonte çështjen si gjykatë e shkallës së dytë, pra në themel, duke marrë në shqyrtim të gjitha provat e paraqitura nga kërkuesit dhe çdo provë

tjetër të nevojshme dhe nuk mund të vendoste mospranimin e rekursit.

14.5. *Standardit të arsyetimit gjyqësor*, pasi vendimet gjyqësore të kundërshtuara nuk janë të arsyetuara. Gjykatat nuk kanë marrë në analizë provat shkresore të administruara në gjykim e aq më pak të kërkonin dhe administronin provat e tjera shkresore. Përfundimet e tyre janë të paarsyetuara dhe pa asnjë analizë juridike, duke mos respektuar kërkesat e neneve 16 e vijuese të KPC-së në lidhje me cilësimin e saktë të fakteve dhe veprimeve që lidhen me mosmarrëveshjen dhe zgjidhjen e saj në përputhje me dispozitat ligjore dhe normat e tjera në fuqi, që kanë qenë të detyrueshme për t'u zbatuar nga ato gjykata.

15. Subjektet e interesuara, shoqëria “Gjallica” në administrim dhe Zyra Përmbarimore Elbasan, nuk kanë paraqitur parashtrime me shkrim edhe pse janë njoftuar rregullisht.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkesave

16. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pikat 1, shkronja “I” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, si dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

17. Gjykata, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pikat 1, shkronja “I” dhe 2, të Kushtetutës, vëren se gjykimi kushtetues për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive kushtetuese vihet në lëvizje me kërkesë të individit, ku sipas nenit 16, pikat 1 dhe 2, të Kushtetutës, përfshihen si të huajt, ashtu edhe personat juridikë, sikurse janë edhe kërkuesit në këtë gjykim. Në këtë këndvështrim, kërkuesit legjitimohen *ratione personae* si bartës të të



drejtave dhe lirive themelore të parashikuara nga Kushtetuta, pasi kanë qenë palë në procesin gjyqësor ndaj të cilit kanë ngritur pretendime në ankimin kushtetues individual dhe kanë interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

18. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “P”, të Kushtetutës, Gjykata vëren se kërkuesit i janë drejtuar asaj me ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm dhe pasi kanë shteruar në formë e substancë mjetet e zakonshme të ankimit ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta. Për rrjedhojë, ata nuk kanë mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese të pretenduara të cenuara përveç paraqitjes së ankimit kushtetues individual.

19. Kërkuesit legjitimohen edhe *ratione temporis* në kuptim të nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, pasi vendimi më i fundit i kundërshtuar, ai i Gjykatës së Lartë, mban datën 27.6.2024, i cili, sipas shkresës së Gjykatës së Lartë, bashkëlidhur kërkesës, është publikuar në faqen e saj zyrtare më 13.9.2024, ndërsa kërkesa është paraqitur në Gjykatë në datën 9.1.2025, pra brenda afatit 4-mujor.

20. Në lidhje me kriterin e legjitimitetit *ratione materiae*, kërkuesit kanë pretenduar cenimin e *parimit të paanshmërisë në gjykim*, pasi gjyqtarët A.A. dhe A.V. kanë marrë pjesë si në trupin gjykues të Gjykatës së Lartë që ka shqyrtuar kërkesën për rivendosjen në afat të padisë, ashtu edhe në atë që ka gjykuar kërkimet e padisë për themelin e mosmarrëveshjes në lidhje me kundërshtimin e veprimeve përmbartimore dhe pavlefshmërinë e titujve ekzekutivë. Sipas kërkuesve, edhe pse është kërkuar përjashtimi ose heqja dorë e këtyre gjyqtarëve, kjo kërkesë është rrëzuar nga Gjykata e Lartë.

21. E drejta për t’u gjykuar nga një gjykatë e paanshme, si element i së drejtës për proces të rregullt, nënkupton mungesën e paragjykimeve nga gjyqtarët në lidhje me çështjen e shtruar përpara tyre dhe që ata të mos veprojnë në mënyrë të tillë që të ndihmojnë interesat e njëjës prej palëve. E drejta për t’u gjykuar përpara një gjykate kompetente, të pavarur dhe të paanshme kërkon që drejtësia jo vetëm duhet të bëhet, por ajo gjithashtu duhet të shikohet që bëhet (*shih vendimet nr. 49, datë 16.10.2023; nr. 38, datë 15.10.2007, të Gjykatës Kushtetuese*). Parimi i paanshmërisë në gjykim edhe në

këndvështrim të përbërjes së trupit gjykues, duhet të respektohet në çdo shkallë të gjykimit, duke mos përjashtuar atë në dhomën e këshillimit të Gjykatës së Lartë. Paragjykimi eventual për paanshinë e gjyqtarit mund të ngrihet edhe në hipotezën se gjyqtari është shprehur në një procedim tjetër me një vlerësim që ka të bëjë me përmbajtjen e të njëjtit fakt, në lidhje me të njëjtin subjekt (*shih vendimin nr. 4, datë 25.2.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Gjykata konstaton se pasi Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka njoftuar datën e shqyrtimit të rekursit në dhomën e këshillimit dhe përbërjen e trupit gjykues, kërkuesit kanë paraqitur kërkesë për përjashtimin e dy prej gjyqtarëve të trupit gjykues, me pretendimin se ndodhen përpara rastit të parashikuar nga neni 72, pika 4, i KPC-së, në situatën që kanë marrë pjesë në trupin gjykues që ka dhënë vendimin nr. 00-2024-17(4), datë 11.1.2024, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, me të cilin është vendosur përfundimisht pushimi i çështjes. Kjo kërkesë është shqyrtuar nga një gjyqtar tjetër i Gjykatës së Lartë, i cili, me vendimin e datës 25.6.2024, ka vendosur rrëzimin e saj si të pabazuar.

23. Bazuar në faktet dhe standardet si më sipër, Gjykata vlerëson se në rastin konkret pjesëmarrja në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë që ka shqyrtuar rekursin e kërkuesve edhe e dy gjyqtarëve të asaj gjykate që kanë marrë pjesë në kolegjin që ka shqyrtuar më parë rekursin e tyre në procesin gjyqësor për rivendosjes në afat të padisë, nuk sjell *a priori* cenim të parimit të paanshmërisë, pasi çdokush mund të vërë në lëvizje të njëjtën gjykatë dhe të njëjtët gjyqtarë për çështje të ndryshme. Në këtë kuptim, pavarësisht se proceset gjyqësore janë vënë në lëvizje nga të njëjtat palë (kërkuesit) dhe në thelb lidhen me të njëjtën mosmarrëveshje, në procesin e parë gjyqësor, duke vendosur pushimin e çështjes, gjyqtarët nuk kanë gjykuar dhe as janë shprehur për faktet dhe ligjin që qëndrojnë në themel të mosmarrëveshjes së palëve ndërgjyqëse, e cila ka qenë objekt i procesit gjyqësor të kundërshtuar. Në kontekst të rrethanave të rastit konkret, për sa kohë që gjyqtarët nuk kanë gjykuar dhe nuk janë shprehur më parë për themelin e kësaj çështjeje, pra për të njëjtën çështje, vetëm pjesëmarrja e tyre në dy vendimet gjyqësore në fjalë nuk krijon dyshim të justifikuar për mungesën e paanshmërisë së tyre në procesin gjyqësor të kundërshtuar. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuesve për



cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme është haptazi i pabazuar.

24. Kërkuesit kanë pretenduar edhe cenimin e *së drejtës së ankimit* sipas nenit 43 të Kushtetutës, pasi për sa kohë që gjykata e apelit ka gjykuar çështjen si shkallë e parë, Gjykata e Lartë duhet ta gjykonte si gjykatë e shkallës së dytë, pra në themel, dhe nuk mund të vendoste mospranimin e rekursit. Neni 43 i Kushtetutës i garanton individit të drejtën për t'u ankuar të paktën një herë ndaj një vendimi gjyqësor të dhënë ndaj tij. Kjo e drejtë kuptohet si mundësi e çdo individit për të pasur mjete të caktuara procedurale për të kundërshtuar vendimin e dhënë nga një gjykatë më e ulët në një gjykatë më të lartë, duke i garantuar individit të drejtën për t'u përballur me drejtësinë në të gjitha nivelet e saj (*shih vendimet nr. 27, datë 9.5.2012; nr. 12, datë 14.4.2010, të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata vëren se në çështjen në shqyrtim gjykata kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjes konkrete ka qenë gjykata e apelit, kurse Gjykata e Lartë është vënë në lëvizje për ushtrimin e juridiksionit rishikues për kontrollin e vendimmarrjes së gjykatës së apelit, në kuptim të nenit 141 të Kushtetutës dhe nenit 43 të Kushtetutës, si instanca më e lartë gjyqësore për kontrollin e zbatimit të ligjit material dhe procedural nga gjykata më e ulët. Në kushtet që Gjykata e Lartë është vënë në lëvizje për shqyrtimin e ankimit ndaj vendimit të gjykatës së apelit, pavarësisht se kjo e fundit e ka shqyrtuar çështjen në shkallë të parë, juridiksioni i saj në rastin konkret është ai rishikues, i përcaktuar nga mjeti procedural i përdorur nga vetë kërkuesit (rekursi) në përputhje me kompetencat e asaj gjykate sipas nenit 141 të Kushtetutës. Në këtë kuptim, Gjykata vlerëson se kërkuesve u është garantuar e drejta e ankimit në një gjykatë më të lartë dhe vetëm fakti i shqyrtimit paraprak të rekursit në dhomën e këshillimit dhe jo në seancë gjyqësore nuk është i tillë që të vërë në dyshim respektimin e së drejtës kushtetuese të ankimit. Për rrjedhojë, edhe ky pretendim i kërkuesve është haptazi i pabazuar.

25. Për sa u përket pretendimeve të tjera të parashtruara në ankimin kushtetues, Gjykata vëren se kërkuesit kanë pretenduar se janë cenuar: *parimi i barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit në gjykim*, për shkak se gjykata e apelit, edhe pse ka gjykuar si shkallë e parë, nuk ka marrë në shqyrtim provat e paraqitura nga kërkuesit dhe nuk ka zhvilluar një hetim shterues; *e drejta për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj* në drejtim të kompetencës të gjykatave

shqiptare për shqyrtimin e kësaj çështjeje; *e drejta e aksesit*, për shkak se përfundimi i gjykatës së apelit për rrëzimin e padisë si të parashkruar është i pabazuar në prova dhe ligj, pasi gjykimi i çështjes ka qenë i lidhur me pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv, padi që nuk parashkruhet dhe mund të ngrihet në çdo kohë; *standardi i arsytimit*, pasi vendimet gjyqësore të kundërshtuara nuk janë të arsyetuara në rrethanat kur për përfundimet e arritura mungon analiza e provave dhe ajo juridike, duke mos vënë përballë faktet dhe provat në raport me ligjin në fuqi, pretendime këto me natyrë kushtetuese, ndaj do të shqyrtohen në vijim në lidhje me bazueshmërinë e tyre në themel. Në lidhje me pretendimet e kërkuesve në drejtim të së drejtës së aksesit dhe të standardit të arsytimit të vendimeve gjyqësore, Gjykata, bazuar në natyrën dhe thelbin e tyre, për sa kohë që kanë të bëjnë me mënyrën sesi gjykata e apelit dhe Gjykata e Lartë kanë trajtuar dhe u kanë dhënë përgjigje pretendimeve të ngritura përpara tyre nga kërkuesit, vlerëson që këto pretendime t'i shqyrtojë në themel së bashku.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit

26. Kërkuesit kanë pretenduar se përfundimi i gjykatës së apelit për rrëzimin e padisë si të parashkruar është i pabazuar në prova dhe ligj, pasi padia për pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv është një padi që, sipas ligjit të kohës, nuk parashkruhet dhe mund të ngrihet në çdo kohë, ndaj gjykata e apelit ishte e detyruar ta shqyrtonte atë në themel, duke marrë të gjitha provat që vërtetësonin se detyrimi nuk ekzistonte ose ekzistonte në një masë më të vogël. Po sipas tyre, vendimet gjyqësore të kundërshtuara nuk janë të arsyetuara. Gjykatat nuk kanë marrë në analizë provat shkresore të administruara në gjykim e aq më pak të kërkonin dhe administronin provat e tjera shkresore. Sipas kërkuesve, përfundimet e tyre janë të paarsyetuara dhe pa asnjë analizë juridike, duke mos respektuar kërkesat e neneve 16 e vijuese të KPC-së, në lidhje me cilësimin e saktë të fakteve dhe veprimeve që lidhen me mosmarrëveshjen dhe zgjidhjen e saj në përputhje me dispozitat ligjore dhe normat e tjera në fuqi, që kanë qenë të detyrueshme për t'u zbatuar nga ato gjykata.

27. Në nenin 42, pika 2, të Kushtetutës parashikohet, ndër të tjera, se kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të tij kushtetues



dhe ligjorë, ka të drejtën e gjykimit të çështjes së tij nga një gjykatë. E drejta e aksesit i garanton individit t'i drejtohet një gjykate, e cila duhet të dëgjojë pretendimet e tij dhe të shpallë një vendim pas një gjykimi të drejtë dhe publik. Kjo e drejtë nuk përfshin vetëm të drejtën për të filluar një proces, por edhe të drejtën për të pasur, nga ana e gjykatës, një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesit në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal (*shih vendimet nr. 31, datë 3.11.2022; nr. 22, datë 29.4.2021; nr. 3, datë 23.2.2016, të Gjykatës Kushtetuese*). Nëse mohohet kjo e drejtë, procesi konsiderohet i parregullt, sepse aksesit në gjykatë është, përpara së gjithash, kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera të individit (*shih vendimet nr. 26, datë 9.4.2024; nr. 22, datë 25.4.2023; nr. 14, datë 21.3.2023, të Gjykatës Kushtetuese*).

28. Nga ana tjetër, kjo e drejtë kushtetuese përfshin edhe atë për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit edhe nga neni 142, pika 1, i Kushtetutës. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funkcioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (*shih vendimet nr. 19, datë 7.7.2022; nr. 2, datë 11.2.2021; nr. 3, datë 20.1.2017, të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë drejtim, për sa u përket vendimeve të dhëna nga Gjykata e Lartë në dhomën e këshillimit, Gjykata ka vlerësuar se nga pikëpamja kushtetuese, vetëm kur janë të pranishme pretendime që kanë të bëjnë me shkeljen e parimeve themelore të procesit gjyqësor, si dhe kur këto pretendime gjejnë pasqyrim në materialet e çështjes, atëherë vendimi i kolegjit për mospranimin e rekursit vë në dyshim të drejtën për proces të rregullt ligjor (*shih vendimet nr. 5, datë 29.1.2025; nr. 22, datë 6.6.2011; nr. 18, datë 18.5.2011, të Gjykatës Kushtetuese*).

29. Duke iu kthyer çështjes në shqyrtim, referuar akteve të dosjes gjyqësore të administruar në gjykimin kushtetues, Gjykata vëren se procesi gjyqësor i kundërshtuar është vënë në lëvizje me padinë e kërkuarve. Ata kanë kundërshtuar veprimin përmbartimor, vendimin e sekuestros, sikundër edhe titujt ekzekutivë, vendimet e administratorëve nr. 15/1999 dhe nr. 2/2009, duke kërkuar anulimin, përveçse edhe pezullimin e ekzekutimit të tyre. Gjithashtu, ata kanë kërkuar edhe rivendosjen në afat të padisë. Në përfundim të gjykimit, Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. 15, datë 12.4.2011,

ka vendosur rrëzimin e padisë së kërkuarve, me arsyetimin se ajo është paraqitur jashtë afatit ligjor të përcaktuar nga ligji i veçantë (ligji nr. 8471/1999) dhe se kërkuar, ndonëse në objektin e padisë kanë kërkuar edhe rivendosjen në afat të saj, nuk paraqitën asnjë provë që të justifikonte mosveprimin në kohë të tyre për kundërshtimin e titujve ekzekutivë.

30. Çështja, në vijim, mbi rekursin e kërkuarve, është shqyrtuar nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, i cili, me vendimin nr. 00-2015-1251(379) datë 9.6.2015, ka prishur vendimin e Gjykatës së Apelit Durrës, duke e kthyer çështjen për rigjykim në Gjykatën Administrative të Apelit. Ai kolegji ka vlerësuar se shoqëria "Gjallica" në administrim, në lidhje me vendimet objekt padie të administratorëve, nuk e ka realizuar njoftimin në përputhje me kërkesat e nenit 6 të ligjit nr. 8471/1999, pasi emrat e debitorëve janë shpallur vetëm në dy gazeta kombëtare, por nuk janë publikuar në mediat elektronike dhe në stendat e asaj shoqërie në administrim, ndërkohë që sipas ligjit njoftimi i debitorit konsiderohet i kryer kur bëhet në të tria mënyrat e njoftimit të përcaktuara në këtë dispozitë. Sipas atij kolegji, gjykata e apelit në rigjykim duhet të hetojë nëse listat ku figurojnë debitorë paditësit (kërkuarve) janë afishuar në stendën pranë selisë së shoqërisë "Gjallica" në administrim dhe nëse ato janë publikuar në ndonjë medie elektronike, ku vetëm pas kryerjes së këtyre veprimeve hetimore dhe çdo veprimi tjetër që do të vlerësohet i domosdoshëm, mund të arrihet në një përfundim të drejtë për afatin e ngritjes së padisë dhe shkaqet e humbjes së tij.

31. Në rigjykim, Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin e ndërmjetëm të datës 8.6.2016, ka vendosur ndarjen dhe gjykimin veçmas të kërkuarve të padisë. Fillimisht, me vendimin nr. 49/2016, ajo gjykatë ka vendosur rrëzimin e kërkuarve për rivendosjen në afat të padisë, me arsyetimin se edhe pse shoqëria "Gjallica" në administrim nuk ka paraqitur akte provuese për publikimin e vendimeve të kundërshtuara të administratorëve të saj nëpërmjet mjeteve elektronike dhe shpalljes së tyre pranë selisë së saj, provohet se paditësit (kërkuarve) padinë për kundërshtimin e titujve ekzekutivë e kanë paraqitur përtej afatit 10-ditor sipas ligjit të veçantë. Paditësit kanë marrë dijeni për ato vendime të administratorëve në datën 14.6.2010, gjatë procedurës së ekzekutimit të detyrueshëm, kur



përfaqësuesit të kërkuarit të tretë i është komunikuar veprimi përmbartimor i sekuestros. Për rrjedhojë, sipas asaj gjykate, ky mosveprim në kohën e duhur passjell humbjen e afatit për shkaqe subjektive që nuk justifikojnë rivendosjen e tij gjyqësisht në kuptim të neneve 151 dhe 152 të KPC-së. Për sa i përket rivendosjes në afat të kundërshtimit të veprimit përmbartimor, gjykata e apelit ka vlerësuar se kundërshtimi i kërkuarit të parë është paraqitur brenda afatit ligjor, ndaj kërkesa e tij për rivendosjen në afat është e papërligjor, kurse kundërshtimet e kërkuarve të tjerë janë paraqitur përtej afatit ligjor 5-ditor.

32. I vënë në lëvizje me rekursin e kërkuarve, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-17(4), datë 11.1.2024, ka vendosur prishjen e vendimit nr. 49/2016 të Gjykatës Administrative të Apelit dhe pushimin e gjykimit të çështjes, me arsyetimin se kërkitimi i kërkuarve për rivendosjen në afat të së drejtës për të ngritur padi kundër përmbartuesit gjyqësor dhe shoqërisë “Gjallica”, sipas nenit 151 të KPC-së, është një kërkitim që nuk mund të ngrihet, pasi instituti i rivendosjes në afat është i zbatueshëm vetëm për afatet procedurale dhe jo për afatet materiale, ndërkohë që afati për ngritjen e padisë rregullohet posaçërisht në të drejtën materiale, pavarësisht ligjit ku ai parashikohet.

33. Për sa i përket procesit të dytë, atij të themelit, Gjykata Administrative e Apelit fillimisht e ka pezulluar gjykimin e çështjes deri në përfundim të procesit gjyqësor për rivendosjen në afat të padisë. Pasi ky proces ka përfunduar në gjykatën e apelit, por përpara se Gjykata e Lartë të vendoste përfundimisht për këtë çështje, Gjykata Administrative e Apelit ka rifilluar gjykimin e çështjes së themelit dhe me vendimin nr. 24 (86-2017-1981), datë 9.5.2017 ka vendosur rrëzimin e padisë së kërkuarve. Sipas asaj gjykate, për zgjidhjen e çështjes duhet të merrte në konsideratë përfundimet e arritura në vendimin nr. 49/2016 të Gjykatës Administrative të Apelit, i cili përbënte vendim gjyqësor të formës së prerë në kuptim të nenit 451/a të KPC-së. Referuar përfundimeve të këtij vendimi, sipas të cilit padia e paditësve (kërkuarve) në lidhje me kërkitimin për anulimin e titujve ekzekutivë, vendimeve të administratorëve nr. 15/1999 dhe nr. 2/2009, është parashkruar për shkak të mosveprimit në kohë të titullarit të së drejtës subjektive, në kuptim të nenit 112 të Kodit

Civil (KC), ajo gjykatë ka vlerësuar se ka pengesë ligjore për shqyrtimin në themel të këtij kërkitimi padie, ndaj duhet të vendosë rrëzimin e tij si padi e parashkruar. Nga ana tjetër, po referuar vendimit të saj nr. 49/2016, gjykata e apelit ka arsyetuar se është rasti për shqyrtimin në themel vetëm të pretendimit të kërkuarit të parë për kundërshtimin e veprimit përmbartimor të sekuestros, për të cilin ai nuk ka parashtruar asnjë shkak se ku konsistojnë shkeljet e kryera nga Zyra e Përmbartimit Elbasan. Sipas saj, pretendimet e këtij kërkuar lidhen vetëm me pabazueshmërinë në fakt dhe në të drejtë të vendimeve të administratorëve nr. 15/1999 dhe nr. 2/2009, të cilat mbeten të pacenuara për shkak të pengesës procedurale për t'i shqyrtuar ato në themel. Për rrjedhojë, edhe ky kërkitim padie është vlerësuar i pabazuar nga ana e asaj gjykate.

34. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, i vënë në lëvizje nga kërkuarit, me vendimin nr. 00-2024-2777, datë 27.6.2024, ka vendosur mospranimin e rekursit të tyre, me arsyetimin se nuk përmban shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 58 të ligjit nr. 49/2012. Ai kolegji ka vlerësuar se shkaqet e parashtruara në rekurs janë të njëjta në përmbajtje me pretendimet/prapësimet në gjykimin administrativ të zhvilluar në gjykatën e apelit, të cilave ajo u ka dhënë përgjigje përfundimtare, duke sqaruar plotësisht rrethanat dhe faktet që lidhen me mosmarrëveshjen objekt gjykimi, si dhe duke bërë një cilësim të saktë të fakteve dhe veprimeve që lidhen me to. Sipas atij kolegji, përfundimi i Gjykatës Administrative të Apelit është rrjedhojë e një analize tërësore dhe objektive të provave dhe të gjitha shkaqeve të parashtruara në rekurs u është dhënë përgjigje në mënyrë shteruese nga gjykata e apelit, e cila ka bërë një analizë të hollësishme nenit 112 të KC-së në lidhje me dispozitat e ligjit nr. 8471/1999, të zbatueshme për mosmarrëveshjen në gjykim.

35. Bazuar në sa më sipër, Gjykata vëren se Gjykata Administrative e Apelit, në procesin gjyqësor të kundërshtuar, nuk ka shqyrtuar në themel padinë e kërkuarve, me argumentin se për të është i detyrueshëm për zbatim vendimi i saj nr. 49/2016, ndonëse ky vendim ishte ankimuar në Gjykatën e Lartë. Ndërkohë, kjo e fundit, ndonëse më herët ka prishur vendimin nr. 49/2016 të Gjykatës Administrative të Apelit dhe ka pushuar gjykimin e asaj çështjeje, në çështjen në shqyrtim ka konsideruar të drejtë qëndrimin e mbajtur nga Gjykata Administrative e Apelit, megjithëse vendimi



ku ajo është bazuar, në momentin e shqyrtimit të çështjes nga Gjykata e Lartë, nuk ishte më pjesë e rendit juridik dhe asnjë diskutim nuk shtrohej për pasjen ai të ndonjë efekti juridik. Në këtë drejtim, Gjykata çmon të rritetshëm se një vendim i gjykatës së apelit konsiderohet si i formës së prerë në kuptim të fuqisë ekzekutive, por ai nuk përbën një vendim përfundimtar me fuqinë e gjësë së gjykuar (*res judicata*) nëse palët kanë përdorur mjetet e zakonshme të ankimit (*shih vendimin nr. 55, datë 7.11.2023 të Gjykatës Kushtetuese*). Pra, në aspektin formal, gjë e gjykuar nënkupton mosankimueshmërinë e vendimit gjyqësor përmes mjeteve të zakonshme, përfshirë edhe të rekursit në Gjykatën e Lartë. Në këtë kuptim, Gjykata Administrative e Apelit ka rrëzuar padinë e kërkuar, pa e shqyrtuar atë në themel, me arsyetimin se ishte parashkruar, duke u bazuar për këtë në një vendim gjyqësor, i cili jo vetëm nuk ishte përfundimtar me fuqinë e gjësë së gjykuar (*res judicata*), për shkak se ndaj tij ishte paraqitur rekurs nga kërkuar, por edhe se më vonë ai u prish nga gjykata më e lartë. Ky qëndrim i Gjykatës Administrative të Apelit u gjet i drejtë nga Gjykata e Lartë, ndonëse ajo, për më tepër, atë vendim gjyqësor të konsideruar si pengesë për shqyrtimin në themel të padisë (vendimin nr. 49/2016 të Gjykatës Administrative të Apelit) e kishte prishur dhe ajo çështje ishte pushuar. Në këtë mënyrë, Gjykata e Lartë nuk ka vepruar në përputhje me funksionin e saj si gjykatë e ligjit, në kuptim të nenit 141 të Kushtetutës, duke mos kontrolluar mënyrën e zbatimit të ligjit nga gjykata e apelit, për më tepër, edhe në kuptim të vendimmarrjes së mëparshme të vetë asaj gjykate.

36. Gjykata vlerëson se ajo mënyrë të vepruar nga gjykatat e zakonshme në procesin gjyqësor të kundërshtuar ka bërë që kërkuar të mos kenë marrë përgjigje përfundimtare për pretendimet e tyre në lidhje me (pa)vlefshmërinë e titujve ekzekutivë dhe, për rrjedhojë të kësaj, edhe të veprimeve të përmbaruesit gjyqësor, duke iu cenuar atyre e drejta e aksesit. Në përfundim, Gjykata çmon se pretendimi i kërkuar për cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor nga gjykata është i bazuar, ndaj vendimet objekt kërkesë duhet të shfuqizohen dhe çështja të dërgohet për rishqyrtim në Gjykatën Administrative të Apelit.

37. Për sa u përket pretendimeve të kërkuar në drejtim të parimit të barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit, për shkak të mosmarrjes së provave dhe moshetimit të çështjes, si dhe së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, e lidhur kjo me kompetencën e gjykatave shqiptare për gjykimin e padisë, Gjykata, në kushtet që çështja e kërkuar do të rigjykohej nga Gjykata Administrative e Apelit, vlerëson të mos ndalet në analizën e tyre, për sa kohë që gjatë gjykimit në themel kërkuar kanë të gjitha mundësitë të kërkojnë paraqitjen ose marrjen e provave, si dhe të parashtrijnë pretendimet e tyre përpara asaj gjykate.

38. Në përfundim, Gjykata çmon se pretendimet e kërkuar për cenimin e së drejtës për proces të rregullt në drejtim të së drejtës së aksesit dhe standardit të arsyetimit janë të bazuara, sipas arsyetimit të mësipërm të këtij vendimi, ndaj kërkesa pranohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “F” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, si dhe nenit 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës.

2. Shfuqizimin e vendimeve nr. 24 (86-2017-1981), datë 9.5.2017, të Gjykatës Administrative të Apelit dhe nr. 00-2024-2777, datë 27.6.2024, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajftueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

3. Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 10.10.2025.

Shpallur më 11.11.2025.

Kryetare: Holta Zaçaj

Anëtarë: Fiona Papajorgji, Marsida Xhaferllari, Genti Ibrahim, Sandër Beci, Sonila Bejtja, Ilir Toska, Marjana Semini



VENDIM
Nr. 339, datë 3.11.2025

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES
“PËR KODIN E ETIKËS DHE
PARANDALIMIN E KONFLIKTIT TË
INTERESIT PËR ANËTARËT E
KËSHILLIT TË LARTË TË
PROKURORISË”

Bazuar në nenet 149, pika 1, dhe 149/a, pika 1, germa “e”, të Kushtetutës, në nenet 159, pika 2, germa “P”, 164, pika 8, 166, 189, pika 1, germa “ç” dhe 190, pika 4, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, dhe në Ligjin nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Këshilli i Lartë i Prokurorisë

VENDOSI:

1. Miratimin e Rregullores “Për Kodin e Etikës dhe parandalimin e konfliktit të interesit për anëtarët e Këshillit të Lartë të Prokurorisë”, sipas tekstit bashkëlidhur.

2. Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në Fletoren Zyrtare dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit.

U shpall në Tiranë, sot, më 3.11.2025.

KRYETAR
Mirela Bogdani

RREGULLORE PËR KODIN E ETIKËS
DHE PARANDALIMIN E KONFLIKTIT
TË INTERESIT PËR ANËTARËT E
KËSHILLIT TË LARTË
TË PROKURORISË

Preambulë

Të vetëdijshëm se integriteti, pavarësia dhe paanshmëria e sistemit të prokurorisë dhe organeve të tij vetëqeverisëse përbëjnë themelin e shtetit të së drejtës në një shoqëri demokratike dhe duke pasur parasysh se këto parime janë të mishëruara në Kushtetutën e Shqipërisë, si dhe në aktet ndërkombëtare pjesë e legjislacionit për sistemin e prokurorisë, Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP) riafirmon përgjegjësinë e tij për të mbrojtur pavarësinë dhe për të ruajtur besimin e publikut,

përmes standardeve më të larta të transparencës, llogaridhënies dhe sjelljes etike.

Duke pasur parasysh se legjitimiteti i KLP-së buron jo vetëm nga respektimi i ligjit, por edhe nga sjellja e anëtarëve të tij dhe duke njohur se roli i tyre në Këshill përfshin funksione qeverisëse dhe administrative, është e domosdoshme të vendoset një kuadër i përbashkët etik, i zbatueshëm për të gjithë anëtarët. Ky kuadër mishëron parimet e integritetit, paanshmërisë, ndershmërisë, përkushtimit dhe eficiencës, si vlera udhëheqëse në ushtrimin e mandatit të tyre.

Kjo Rregullore, e frymëzuar nga kuadri ligjor kombëtar dhe standardet evropiane, synon të forcojë detyrimin e anëtarëve për të vepruar në interes publik, për të parandaluar konfliktet e interesit dhe për të garantuar paanshmërinë dhe dukjen e saj, të cilat janë të pandashme nga pavarësia dhe integriteti. Duke afirmuar këto parime, Rregullorja forcon legjitimitetin e KLP-së dhe rrit besimin e shoqërisë tek sistemi i prokurorisë, në tërësi.

Këshilli i Lartë i Prokurorisë shpall solemnisht angazhimin e tij të palëkundur për të mbrojtur, promovuar, standardet më të larta etike dhe vendos të ushtrojë veprimtarinë e tij me dinjitet, transparencë dhe përgjegjësi.

Neni 1
Parimi i pavarësisë

1. Anëtarët e Këshillit të Lartë të Prokurorisë ushtrojnë kompetencat e tyre me pavarësi të plotë, të udhëhequr vetëm nga ligji. Për këtë qëllim, ata ruajnë pavarësinë nga çdo ndikim i brendshëm apo i jashtëm dhe nuk kërkojnë, apo marrin udhëzime, nga asnjë person, institucion, organ apo entitet.

2. Anëtarët e Këshillit të Lartë të Prokurorisë duhet të mbeten të pavarur nga çdo individ apo grup i mundshëm interesi, si nga brenda sistemit të prokurorisë, ashtu edhe nga jashtë tij.

3. Reagimi ndaj kritikave dhe/ose sulmeve ndaj sistemit të prokurorisë dhe vetë Këshillit duhet të jetë i ekuilibruar dhe objektiv, duke synuar të shprehë saktësisht qëndrimin e institucionit, pa hyrë në gjykime të panevojshme vlerash.



Neni 2

Parimi i paanshmërisë

1. Në kryerjen e detyrave të tij, anëtari i Këshillit të Lartë të Prokurorisë është i paanshëm dhe duket si i tillë, pa paragjykime në lidhje me interesa ose marrëdhënie personale, sociale ose politike. Në gjithë sjelljen e tyre, ai siguron që të mos lindë asnjë dyshim lidhur me paanshmërinë e tyre në ushtrimin e funksionit dhe për shkak të tij.

2. Anëtarët e Këshillit të Lartë të Prokurorisë nuk veprojnë, apo shprehen, në asnjë formë apo mjet komunikimi, në një mënyrë që ndikon negativisht në perceptimin publik të paanshmërisë së tyre dhe shmangin çdo situatë që mund të çojë në një konflikt interesi ose që objektivisht mund të perceptohet si e tillë, me përjashtim të mbledhjeve plenare, komisioneve dhe grupeve të punës.

Neni 3

Parimi i integritetit

1. Anëtarët e Këshillit të Lartë të Prokurorisë gjatë ushtrimit të detyrës dhe jashtë saj, ruajnë reputacionin, dinjitetin e institucionit dhe besimin në integritetin e tyre.

2. Anëtarët e Këshillit të Lartë të Prokurorisë përmbushin rolin e tyre në interesin më të mirë të sistemit të prokurorisë dhe të shoqërisë, sipas parimit të integritetit, duke vepruar me ndershmëri dhe duke synuar arritjen e standardit më të lartë të sjelljes profesionale dhe personale.

3. Anëtarët e Këshillit të Lartë të Prokurorisë veprojnë në përputhje me detyrimin për ndershmëri dhe dinjitet, duke u përmbajtur nga çdo sjellje që bie në kundërshtim me ligjin, si dhe shmang çdo sjellje që tregon mungesë ndjeshmërie apo kujdesi gjatë ushtrimit të funksionit dhe jashtë tij.

Neni 4

Parimi i bashkëpunimit dhe respektit

1. Anëtarët e Këshillit të Lartë të Prokurorisë duhet të bashkëpunojnë me njëri-tjetrin në shërbim të interesit më të mirë të prokurorëve, sistemit të prokurorisë dhe interesit publik. Kryetari i Këshillit ka rol në krijimin, ruajtjen e besimit dhe bashkëpunimin mes anëtarëve, duke siguruar që çdo anëtar të ketë qasje të barabartë në informacion dhe në vendimmarrje.

2. Aktivitete që ndihmojnë në krijimin e një mjedisi të shëndetshëm pune dhe që ndërtojnë dhe forcojnë besimin mes anëtarëve të Këshillit, duhet të promovohen.

3. Anëtarët e Këshillit të Lartë të Prokurorisë duhet të komunikojnë me njëri-tjetrin dhe me të tjerët, në mënyrë të respektueshme dhe të punojnë me konsideratën e duhur ndaj të tjerëve, duke synuar që vlerat e respektit dhe dëgjimit të ndahen dhe të zbatohen.

Neni 5

Parimi i respektit dhe i aftësisë për të dëgjuar

1. Për të përmbushur detyrat e tyre në mënyrë kompetente, të pavarur dhe të paanshme, anëtarët e Këshillit të Lartë të Prokurorisë përftojnë, ruajnë dhe zhvillojnë njohuri dhe aftësi të rëndësishme për këto detyra, siç janë aftësia për të punuar në grup dhe aftësitë e komunikimit.

2. Anëtarët e Këshillit të Lartë të Prokurorisë zhvillojnë të menduarin strategjik, për funksionimin sa më të mirë të sistemit të prokurorisë dhe veprojnë në përputhje me rregullat ekzistuese dhe standardet e kujdesit të duhur.

Neni 6

Parimi i besnikërisë

1. Anëtarët e Këshillit të Lartë të Prokurorisë duhet të përmbushin detyrimin e tyre për besnikëri ndaj sistemit të prokurorisë dhe duhet të jenë të përkushtuar për mbrojtjen e pavarësisë.

2. Anëtarët e Këshillit të Lartë të Prokurorisë i përkushtohen përmbushjes së detyrimeve të tyre ligjore. Ata duhet të sigurojnë prani të vazhdueshme në mbledhjet plenare, në komisione në të cilat janë anëtarë dhe të menaxhojnë burimet materiale të institucionit në mënyrë të përgjegjshme.

3. Anëtarët e Këshillit të Lartë të Prokurorisë shmangin dhënien e deklaratave jashtë institucionit, që mund të dëmtojnë rëndë reputacionin e tyre.

Neni 7

Parimi i transparencës

1. Transparenca është e rëndësishme në rritjen e ndërgjegjësimin të publikut dhe përmirësimin e besimit të publikut. Anëtarët e Këshillit të Lartë të



Prokurorisë duhet të veprojnë në mënyrë transparente, duke qenë në dispozicion për të dhënë arsyetime për vendimet që marrin dhe duke raportuar për aktivitetet e tyre jashtë Këshillit, në lidhje me kryerjen e detyrave të tyre si anëtarë të Këshillit.

2. Kur shprehet një mendim personal dhe jo institucional, është e domosdoshme të specifikohet ky fakt, duke shpjeguar arsyet e një pikëpamjeje të ndryshme ose që dallon nga ajo e institucionit që përfaqësojnë.

Neni 8

Parimi i konfidencialitetit

Anëtarët e Këshillit të Lartë të Prokurorisë respektojnë natyrën konfidenciale të punës së tyre kur kërkohet me ligj dhe promovojnë respektimin e rregullave të mbrojtjes së të dhënave personale. Detyrimi i konfidencialitetit mbetet edhe pas përfundimit të mandatit.

Neni 9

Konflikti i interesit dhe detyrimi për heqje dorë

1. Çdo anëtar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë ushtron kujdesin e duhur për të shmangur pjesëmarrjen në një çështje, ku ekziston ose mund të perceptohet në mënyrë të arsyeshme se ekziston një konflikt interesi, në përputhje me nenet 171–175, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, dhe me këtë Rregullore.

2. Situatat që japin shkas për konflikt interesi përfshijnë, por nuk kufizohen, vetëm në papajtueshmërinë, për shkak të pjesëmarrjes në procedim, papajtueshmërinë për shkak të lidhjeve familjare, gjinie ose krushqie, si dhe rastet e heqjes dorë të anëtarëve të Këshillit, si lidhje financiare, juridike ose profesionale ndërmjet anëtarit (ose të afërmeve të tij të ngushtë) dhe subjektit të procedurës.

3. Anëtari që identifikon një konflikt personal interesi është i detyruar ta deklarojë menjëherë dhe të mos marrë pjesë më tej në diskutim ose votim për çështjen. Në rast se anëtari nuk është i sigurt nëse rrethanat përbëjnë konflikt interesi, ai/ajo mund të paraqesë kërkesë për heqje dorë, deri në marrjen e vendimit nga kryetari i Këshillit, zëvendëskryetari

ose mbledhja plenare, sipas dispozitave ligjore në fuqi.

4. Kërkesa për deklarimin e konfliktit të interesit ose kërkesës për heqje dorë, duhet të paraqitet pa vonesë dhe, në çdo rast, para fillimit të diskutimeve mbi çështjen. Deri në marrjen e vendimit, anëtari subjekt i kërkesës për përjashtim, nuk merr pjesë në procedurë.

Neni 10

Përjashtimi i një anëtari nga procedimet për shkak të konfliktit të interesit

1. Një anëtar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë mund të përjashtohet nga një procedim, për shkak të konfliktit të interesit:

a) Me kërkesë të vetë anëtarit të interesuar (kërkesë për heqje dorë);

b) Me kërkesë të paraqitur nga një anëtar tjetër i Këshillit;

c) Me kërkesë të paraqitur nga prokurori, funksionari publik ose pala e përfshirë në çështje.

2. Kërkesat për përjashtimin e një anëtari duhet të paraqiten pa vonesë dhe, në çdo rast, para fillimit të diskutimeve thelbësore mbi çështjen. Deri në marrjen e vendimit, anëtari subjekt i kërkesës për përjashtim nuk merr pjesë në procedurë.

3. Në rastet kur kryetari ose zëvendëskryetari i Këshillit paraqesin kërkesë për heqje dorë për shkak të konfliktit të interesit lidhur me marrëdhëniet familjare, farefisnore ose martesore, kërkesa shqyrtohet respektivisht nga zëvendëskryetari ose kryetari i Këshillit.

4. Nëse kërkesa lidhet me një konflikt të mundshëm interesi sipas neneve 171 ose 174 të ligjit nr. 115/2016, i ndryshuar, vendimin për përjashtimin e anëtarit e merr mbledhja plenare, me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm, pa pjesëmarrjen e anëtarit subjekt i vendimmarrjes.

5. Anëtarit subjekt i kërkesës dhe i vendimmarrjes, i jepet mundësia të paraqesë qëndrimin e tij/saj para se të merret vendimi.

6. Nëse mbledhja plenare vendos për përjashtimin e anëtarit, Këshilli vijon procedimin pa pjesëmarrjen e anëtarit të përjashtuar dhe vendimi për përjashtim pasqyrohet në procesverbalin e mbledhjes. Nëse mbledhja plenare nuk pranon kërkesën për përjashtim, anëtari vijon të marrë pjesë në procedim dhe nuk përjashtohet. Vendimi bëhet pjesë e dosjes ose raportit përfundimtar të çështjes.



7. Në çdo rast, nëse mbledhja plenare konstaton se një anëtar, me dashje, nuk e ka deklaruar konfliktin e interesit dhe më pas vendos për përjashtimin e tij/saj, Këshilli ia referon çështjen Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për shqyrtim të mëtejshëm, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

Neni 11 Zbatimi

1. Këshilli i Lartë i Prokurorisë duhet të shqyrtojë mundësinë e krijimit të një komisioni për etikën për të evidentuar në kohën e duhur çështje etike dhe shkelle të mundshme. Komisioni duhet të zhvillojë konsultime mbi çështjet etike dhe të angazhohet në aktivitete për rritjen e ndërgjegjësimit mbi standardet etike.

2. Duhet të merret, gjithashtu, në konsideratë vendosja e një procedure, që t'i japë mundësi çdo anëtarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë të sjellë në vëmendjen e komisionit dhe/ose të mbledhjes plenare çështje problematike, që lidhen me zbatimin e Rregullores.

Neni 12 Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi në datën e botimit në Fletoren Zyrtare.

KËRKESË
Nr. 880/10, datë 11.11.2025

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën “Për shpronësim, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit ‘Rikonstruksion i rrugës ekzistuese ‘Xhaferr Belegu’, ndodhur në ZK 8527, Bashkia Elbasan””, me vlerë totale paraprake të shpronësimit 1,480,494.42 (një milion e katërqind e tetëdhjetë mijë e katërqind e nëntëdhjetë e katër pikë dyzet e dy) lekë.

Subjekti kërkuar i këtij projekti është Bashkia Elbasan.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për pasurinë, pronë private, të cilët do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur, bazuar në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, për pasurinë e llojit “arë”, “ullishte”, “truall + ndërtesë”, sipas tabelës paraprake bashkëlidhur.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 1,480,494.42 (një milion e katërqind e tetëdhjetë mijë e katërqind e nëntëdhjetë e katër pikë dyzet e dy) lekë.

Personat që preken nga ky projekt, të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar dhe personat të cilët preken, por nuk figurojnë në këto lista, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara, për përfundimin e procedurave të shpronësimit, pranë Bashkisë Elbasan, si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësimin.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Ermal Shena

Page | 25487

**KËRKESË****Nr. 942/8, datë 11.11.2025****PËR SHPRONËSIM PUBLIK**

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën, “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit ‘Baza Ajrore Farkë’”, me vendndodhje në Bashkinë Tiranë, me subjekt zhvillues Ministrinë e Mbrojtjes, me vlerë totale paraprake 18,396,117 (tetëmbëdhjetë milionë e treqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e njëqind e shtatëmbëdhjetë) lekë.

Subjekti kërkues i këtij projekti është Ministria e Mbrojtjes, Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosur, Komanda e Forcës Ajrore.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për interes publik, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilat do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur.

Për pasuritë e llojit “arë” është bërë bazuar në vendimin nr. 89, datë 3.2.2016, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”.

Personat që preken nga ky projekt, të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar, dhe personat të cilët preken, por nuk figurojnë në listë, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara për përfundimin e procedurave të shpronësimit, në Ministrinë e Mbrojtjes, Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosur, Komanda e Forcës Ajrore, si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësim.

Vlera totale paraprake e shpronësimit 18,396,117 (tetëmbëdhjetë milionë e treqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e njëqind e shtatëmbëdhjetë) lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Ermal Shena

																							"Hypotekë ligjore së kredisë së dhënë nga institucionet bankare", me emërime "Kontratë/deklarate materiale për vendosje hypoteke", me nr. regjistri 00001931, datë 9.12.2021, "Pasura llokohehet në favor të "UNIFIN" për vlerën 22000 euro, kontratë hipotekare nr. 2939/1298 rep./kol., datë 25.11.2021.
18	Klodian	Muharret	Maqellara	TIRANË	3550	206/14	ARË	329.2	329.2	10	132	329	448	147,482	-	-	65,956	213,438	Konfirmuar nga DVASHK Rurale 1, datë 20.10.2025				
19	Faik	Muharret	Maqellara	TIRANË	3550	206/15	ARË	329.2	329.2	10	133	329	448	147,482	-	-	65,956	213,438	Konfirmuar nga DVASHK Rurale 1, datë 20.10.2025				
20	Mimosa	Muharret	Zelaj	TIRANË	3550	206/16	ARË	329.2	329.2	10	134	329	448	147,482	-	-	65,956	213,438	Konfirmuar nga DVASHK Rurale 1, datë 20.10.2025				
21	Raimonda	Muharret	Gaushllari	TIRANË	3550	206/17	ARË	329.2	329.2	10	135	329	448	147,482	-	-	65,956	213,438	Konfirmuar nga DVASHK Rurale 1, datë 20.10.2025				
22	Liliana	Muharret	Maqellara	TIRANË	3550	206/18	ARË	329.2	329.2	10	136	329	448	147,482	-	-	65,956	213,438	Konfirmuar nga DVASHK Rurale 1, datë 20.10.2025				
23	Haki	Sulejman	Ptaku	TIRANË	1604	58/14	ARË	1867	1867	13	113	406	448	181,888	-	-		181,888	Konfirmuar nga DVASHK Rurale 1, datë 20.10.2025				
24	Xhemale	Ali	Mariq	TIRANË	1604	68/11	ARË	1150	1150	10	243	1,050	448	470,400	-	-		14,700	485,100	Konfirmuar nga DVASHK Rurale 1, datë 20.10.2025			
	Zyber	Mehmet	Mariq																				
	Sokol	Mehmet	Mariq																				
	Ermir	Mehmet	Mariq																				
	Mustaf	Mehmet	Mariq																				
25	Kreslim	Mehmet	Mariq																				
25	Gezim	Hijdar	Duraku	TIRANË	1604	68/12	ARË	2000	2000	10	244	1,437	448	643,776	-	-	12,200	655,976	Konfirmuar nga DVASHK Rurale 1, datë 20.10.2025				
26	Haxhi	Zemel	Dina	TIRANË	1604	68/3	ARË	6700	6700	1	213	6,700	448	3,001,600	-	-	29,920	3,031,520	Konfirmuar nga DVASHK Rurale 1, datë 20.10.2025				
27	Lulzim	Sefer	Dina	TIRANË	1604	68/14	ARË	3685	3685	12	246	3,685	448	1,650,880	-	-	50,480	1,701,360	Konfirmuar nga DVASHK Rurale 1, datë 20.10.2025. Me nr. regjistri 3477, datë 4.3.2024, Bop i kufizimit "Garancë hipotekare/llokohe në favor të të treteve", kontratë e shitjes këmbimi ose dhurimi me rezervë/kusht të pasurisë së paluajtshme nr. 1387/617, datë 23.2.2024				
28		Shutet		TIRANË	3550	227/12	Ullishte	5340		5	137	609	0	-	-	-				Konfirmuar nga DVASHK Rurale 1, datë 18.4.2025			
SHUMA PARAPRAKE														17,287,872	-	-	1,108,245	18,396,117					

**KËRKESË****Nr. 980/7, datë 11.11.2025****PËR SHPRONËSIM PUBLIK**

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rikonstruksion rruga ‘Marin Biçikemi’”.

Subjekti kërkues i këtij projekti është Bashkia Shkodër

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilët do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur për pasuritë e llojit “truall”, bazuar në vendimin nr. 89, datë 3.2.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, sipas tabelës paraprake bashkëlidhur.

Personat fizikë ose juridikë që preken nga realizimi i këtij projekti, emri i të cilëve pasqyrohet në tabelën e publikuar, si dhe personat fizikë ose juridikë, të cilët preken, por nuk figurojnë në këtë listë, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara për përfundimin e procedurave të shpronësimit, pranë Bashkisë Shkodër, si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësimet.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 859,611 lekë (tetëqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind e njëmbëdhjetë) lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Ermal Shena



LISTA PARAPRAKE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR INTERES PUBLIK NGA PROJEKTI "RIKONSTRUKSION
RRUGA MARIN BIÇIKEMI"

Nr.	PRONARI			TË DHËNA KADASTRALE									VLERËSIMET PËR SHPRONËSIM						VLERA TOTALE (lekë)	SHËNIME (kufizime hipotekare, barrë mbi pasurinë etj.)
													Truall			Ndërtesë banimi				
	Emri	Atësia	Mbiemri	Qyteti	Z. kadastrale	Indeksi i hartës	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja totale (m ²)	Truall (m ²)	Volumi	Faqe	Sipërfaqja (m ²)	Çmimi (lekë / m ²)	Vlera (lekë)	Sipërfaqja (m ²)	Çmimi (lekë / m ²)	Vlera (lekë)		
A	B	C	Ç	D	E	F		G	H	I	J	K	L	M				Q	R	
1	FRANÇESKO		GJELOSHI	Shkodër	8593	M-9	4/343	TRUALL	101	101	23	119	101	8511	859,611	56	0	-	859,611	Objekt i shembur
2	SHTET			Shkodër	8593	M-9	4/269	RRUGE	163.75	163.75	41	49	100	0	-				-	
3	SHTET			Shkodër	8593	M-9	4/265	RRUGE	295	295	9	49	179.73	0	-				-	
4	SHTET			Shkodër	8593	M-9	4/760	TRUALL	78.61	78.61	36	218	56.75	0	-				-	
5	PVN SHPK			Shkodër	8593	M-9	4/676-B2	TRUALL	608	608	29	207	43	0	-				-	Kjo pasuri bie në shesh funksional pallati, menaxhuar me leje ndërtimi
6	DEDE		FUSHAJ	Shkodër	8593	M-9	4/667	TRUALL	932.3	932.3	27	86	105.68	0	-				-	Kjo pasuri bie në shesh funksional pallati, menaxhuar me leje ndërtimi
TOTAL													859,611			-			859,611	

**KËRKESË****Nr. 1073, datë 11.11.2025****PËR SHPRONËSIM PUBLIK**

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rikonstruksion trotuari perimetral shkolla 9-vjeçare ‘Ndre Mjeda’”.

Subjekti kërkues i këtij projekti është: Bashkia Shkodër

Me anë të këtij publikimi, kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilët do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur për pasuritë e llojit “truall”, bazuar në Vendimin nr. 89, datë 3.2.2016 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, dhe pasuritë e llojit “ndërtesë jobanimit” përlllogaritur në bazë të VKM Nr. 138, datë 23.3.2000 “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, i ndryshuar, sipas tabelës paraprake bashkëlidhur.

Personat fizikë ose juridikë që preken nga realizimi i këtij projekti, emri i të cilëve pasqyrohet në tabelën e publikuar si dhe personat fizikë ose juridikë, të cilët preken, por nuk figurojnë në këtë listë, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara për përfundimin e procedurave të shpronësimit, pranë Bashkisë Shkodër, si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësimet.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 1,749,932.10 lekë (një milion e shtatëqind e dyzet e nëntë mijë e nëntëqind e tridhjetë e dy pikë dhjetë) lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Ermal Shena



LISTA PARAPRAKE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR INTERES PUBLIK NGA PROJEKTI “RIKONSTRUKSION TROTUARI PERIMETRAL SHKOLLA 9- VJEÇARE ‘NDRE MJEDA’”

Nr	PRONARI			TË DHËNA KADASTRALE									VLERËSIMET PËR SHPRONËSIM						VLERA TOTALE (lekë)	SHËNIME (kufizime hipotekore, barrë mbi pasurinë etj.)
													Truall			Ndertesë social ekonomike				
	Emri	Atësia	Mbiemri	Qyteti	Z. kadastrale	Indeksi i hartes	Nr. pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja totale (m ²)	Truall (m ²)	Volumi	Faqe	Sipërfaqja (m ²)	Çmimi (lekë/m ²)	Vlera (lekë)	Sipërfaqja (m ²)	Çmimi (lekë/m ²)	Vlera (lekë)		
A	B	C	Ç	D	E	F		G	H	I	J	K	L	M	N	O	P	Q	R	
1	REMZI	EJUP	ZENELI	Shkoder	8591	N-6	1/701	TRUALL	55.1	55.1	22	217	55.1	8511	468,956.10	49.92	0	1,280,976	1,749,932.10	Në seksionin “E”, të Kartelës së Paturisë së Paluatjshme, pasqyrohet shënimi: “Korrigjim hartografik i spërfaqes dhe i numrit të pasurisë sipas referencës 011406, leje legalizimi nr. 3314, datë 21.7.2010, godinë socio-ekonomike 1-katëshe”.
2	SHTET			Shkoder	8591	N-6	1/512	TROTUAR	256.82	256.82	22	213	119	8511	-	0	0	-	-	Në seksionin “E”, të Kartelës së Paturisë së Paluatjshme, pasqyrohet shënimi: “Korrigjim hartografik dhe sipërfaqes sipas referencës 011406”.
3	SHTET			Shkoder	8591	N-6	1/1080	SHESH	8047.6	8047.6	9	49	20	8511	-	0	0	-	-	Në seksionin “C”, të Kartelës së Paturisë së Paluatjshme, pasqyrohet referenca 00017714, datë 9.5.2017: “Mbi këtë pasuri bie pasuria e llojit ndërtesë me nr 1/852/2, regjistruar në volum 56, f. 230.
	TOTALI								8359.52				194		468,956	49.92		1,280,976	1,749,932.10	

**KËRKESE**

Shtetasi Beshir Gjergji kërkon pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës shpalljen e zhdukjes së shtetasit Saimir Gjergji, që nga gushti i vitit 1991, i lindur më datë 27.11.1971, me atësi Halil dhe me amësi Mejte.

KËRKUES
Beshir Gjergji

KORRIGJIM GABIMI MATERIAL

Në urdhrin nr. 1120, datë 3.11.2025, të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, “Për miratimin e rregullores ‘Për menaxhimin e peshkimit në Zonën e Kufizuar të Peshkimit në Kanalin e Otrantos (GSA 18)’”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 209, datë 12.11.2025, bëhet korrigjimi, si më poshtë:

Ishte:
MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT
RURAL
Anila Denaj

Bëhet:
MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT
RURAL
Andis Salla

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2025

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 208 lekë

